R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

**T I R A N Ë**

K Ë R K E S Ë

PËR DËRGIMIN E ÇËSHTJES NË GJYQ

GJYKATËS SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

T I R A N Ë

Në përfundim të hetimit të procedimit penal nr.29/1 të vitit 2019 (339 të viti 2016) të filluar në datën 20.12.2019, kundër të pandehurve:

1. **Astrit Balliu (alis AvdyIi,Sulejmani),** i biri i Zeqo dhe i Qamile, i datëlindjes 06.09.1974, lindur dhe banues në Shijak, Durrës, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av. Z. Maksim Haxhia dhe Dritan Jahaj.

**I akuzuar** për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve" në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", " Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 283/a/l, 28/4, 278/1, 333/a/2 334/1 të Kodit Penal,

2. **Altin Avdyli,** i biri i Zeqo dhe i Qamile, i datëlindjes 27.02.1977, lindur dhe banues në Shijak, Durrës, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av. Z. Maksim Haxhia dhe Dritan Jahaj.

**I akuzuar** për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, " Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 283/1, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal,

3. **Jasin Kala (alias Avdyli),** i biri i Riza dhe i Fatime, i datëlindjes 05.09.1968, lindur dhe banues në Shijak, Durrës, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i dënuar, i mbrojlur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z. Baftjar Rusi dhe Vojo Bregu.

**I akuzuar** për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, "Pastrimi i produkteve të veprës penale", në bashkëpunim, " Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 283/1, 28/4, 287/1 gërma "b", 25, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal,

4. **Gjevi Ndoka (alias Xhevahir),** i biri i Ndue dhe i Dile, i datëlindjes 11.04.1982, lindur dhe banues në Lezhë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, I mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z.Ardian Visha dhe Arben Prenga.

**I akuzuar** për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve" në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, " Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 283/a/l, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

5. **Esat Mehmeti,** i biri i Abas dhe i Ervehe, i datëlindjes 28.04.1965, lindur dhe banues në Fier, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z.Arben Rakiki dhe Z. Ermir Beta.

**I akuzuar** për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Trafikimi i narkotikëve" në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, " Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 283/1, 283/a/l, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal

6. **Petrit Sulejmani,** i biri i Jemin dhe i Refie, i datëlindjes 21.04.1972, lindur dhe banues në Patos, Fier, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z.Arben Peci.

**I akuzuar** për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve" në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, " Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata

[shqiptarja.com]

kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 283/a/l, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

**7.** **Saimir Sulejmani,** i biri i Jemin dhç,i Refie, i datëlindjes 09.01.1979, lindur dhe banues në Patos, Fier, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z. Alban Bengasi dhe Z.Elton Hyseni.

**I akuzuar** për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve" në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, " Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 283/a/l, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

**8.** **Hajri Seferi,** i biri i Myrteza dhe i Bukurie, i datëlindjes 22.07.1977, lindur dhe banues në Shijak, Durrës, me kombësi dhe shtetësi shqiplare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z. Armand Tragaj.

**I akuzuar** se ka kryer veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", 'Trafikimi i narkotikëve" në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, " Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 283/1, 283/a/l, 28/4, 333/a/l, 334/1 të Kodit Penal.

**9.** **Orges Jahelezi,** i biri i Ferizit dhe i Nurijes, lindur më 20.01.1977, lindur në Bajram Curri dhe banues në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z.Alban Bengasi dhe Elton Hyseni.

**I akuzuar** për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, " Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 283/1,28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

**10.** **Shkëlqim Avdyli,** i biri i Riza dhe i Fatinie, i datëlindjes 03.11.1969, lindur dhe banues në Shijak, Durrës, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z. Baftjar Rusi dhe Vojo Bregu.

**I akuzuar** për veprat penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale", në bashkëpunim, parashikuara nga neni 287/1 gërma "b", 25, i Kodit Penal.

**11.** **Denis Llaftiu,** i biri i Fatos dhe i Lule, i datëlindjes 16.10.1986, lindur dhe banues në Shijak, Durrës, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z. Arben Peci.

**I akuzuar** për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, " Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 283/1, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

**12.** **Saimir Gjepali,** i biri i Abdyl dhe i Hajrije, i datëlindjes 02.04.1974, lindur dhe banues në Shijak Durrës, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z.Henrik Ligori dhe Z. Arjan Salati.

**I akuzuar** për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", në bashkëpunim, "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëye, armëve shpërthyese dhe municionit", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërlhyese dhe municionit", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive", parashikuara nga nenet 283/2, 278/2, 278/3, 280 të Kodit Penal.

**13. Mario Zeqiri (alias Edinjo),** i biri i Fejzi dhe i Dallandyshe, i datëlindjes 28.04.1983, lindur dhe banues në Sukth i Ri, Shijak, Durrës, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z. Armand Tragaj.

**I akuzuar** se ka kryer veprën penale ''Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 të Kodit Penal.

**13.** **Elton Shehaj,** i biri i Bashkim dhe i Keze, i datëlindjes 08.01.1976, lindur dhe banues në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z.Armand Tragaj.

**I akuzuar** se ka kryer veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 të Kodit Penal.

[shqiperia.com]

**14.** **Fatos Llaftiu,** i biri i Sali dhe i Lumturie, i datëlindjes 13.02.1958, lindur dhe banues në Shijak, Durrës, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z.Agron Lamaj.
**I akuzuar** për veprën penale "Moskallëzimi i krimit", parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal,
**15.** **Ardit Gjyriqi,** i biri i Shpend dhe i Sabrie, i datëlindjes 06.05.1985, lindur në Tropojë dhe banues në Tiranë,me arsim të lartë, me gjendje familjare i martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Znj.Enkelejda Hysaj.
**I akuzuar** për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal,
**16.** **Admir Hoxha,** i biri i Gëzim dhe i Shpresa, i datëlindjes 17.10.1976, lindur dhe banues në Krujë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z.Maks Haxhia dhe Dritan Jahaj.
**I akuzuar** për veprat penale " Trafikimi i narkotikëve" ,"Prodhimi dhe fabrikimi i lendeve narkotike dhe psikotrope " ,në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, " Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal " , "Pastrimi i produkteve të veprës penale", në bashkëpunim, parashikuara nga nenet 283/a/l, 284/c, 28/4, 287/1 gërma ''b", 25, 333/a/l, 334/1 të Kodit Penal,
**17.** **Hekuran Hoxha,** i biri i Nazmiut dhe i Fitnetes, i datëlindjes 02.10.1970, lindur dhe banues në Durrës, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i dënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z. Ardian Visha dhe Z.Arben Prenga.
**I akuzuar** për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve", ''Prodhimi dhe fabrikimi i lendeve narkotike dhe psikotrope " ,në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, " Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal " , "Pastrimi i produkteve të veprës penale", në bashkëpunim, parashikuara nga nenet 283/a/l, 284/c, 28/4, 287/1 gërma ''b", 25, 333/a/l, 334/1 të Kodit Penal,
**Iskënder Sale(alias Mehmet Gjini),** i biri i Xhemal dhe i Have, i datëlindjes 03.01.1983, lindur në Turqi, banues në Rruga "Hyzri Talla"H-IV Nr.6, Fushë Kosovë, me kombësi dhe shtetësi turke, me gjendje gjyqësore i padënuar. i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga mbrojtës kosovar.
**I akuzuar** për veprat penale " Trafikimi i narkotikëve" , "Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope", në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, " Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, parashikuara nga nenet 283/a/l, 284/c, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal,
**18.** **Xhemal Shala,** i biri i Halit dhe i Time, i datëlindjes 29.04.1950, lindur në Ozdrim, Peje, banues në Rruga "Hyzri Talla"H-IV Nr.6, Fushë Kosovë, me kombësi shqiptare dhe shtetësi turke, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga mbrojtës kosovar.
**I akuzuar** për veprat penale " Trafikimi i narkotikëve" , "Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope", në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, " Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, parashikuara nga nenet 283/a/l, 284/c, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
**19.** **Xhevit Shuti,** i biri i Mustafë dhe i Nadire, i datëlindjes 03.02.1970, lindur dhe banues në Brenogë, Has, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z.Agim Tirana.
**1 akuzuar** për veprat penale " Trafikimi i narkotikëve" , "Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope", në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, " Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, parashikuara nga nenet 283/a/l, 284/c, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal,
**20.** **Flamur Çelaj,** i biri i Bisho dhe i Hajries, i datëlindjes 06.08.1970, lindur dhe banues në Shkodër, me arsim të mesëm, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z.Tonin Prendi.
**I akuzuar** për veprat penale " Trafikimi i narkotikëve" , "Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope", në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, parashikuara nga nenet 283/a, 284/c, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal,
**21.** **Vehbi Berushi,** i biri i Rexhep dhe i Feride, i datëlindjes 04.11.1961, lindur dhe banues në lagjen Nr.4 të Bashkisë Krujë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z.Përparim Noka.

[shqiptaria.com]

**I akuzuar** për veprat penale “ Trafikimi i narkotikëve” , “Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope”, në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, “ Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, parashikuara nga nenet 283/a/l, 284/c, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal

**22. Mustaf Shuti,** i biri i Ahmet dhe i Kade, i datëlindjes 10.05.1942, lindur ne Has dhe banues në Qafë-Zotaj, Durrës, me arsim tetëvjeçarë, me gjendje familjare i martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z.Agim Tirana.

**I akuzuar** për veprën penale “Mbajta, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 285, 25 i Kodit Penal,

**23. Anila Shuti,** e bija e Din dhe e Sabrijes, e datëlindjes 20.01.1976, lindur në Kishaj, Has dhe banues në Brenogë, Has, me arsim të mesëm, me gjendje familjare e martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore e padënuar, e mbrojtur gjatë hetimeve paraprake nga av.Z.Agim Tirana

**E akuzuar** për veprën penale “Mbajta, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 285, 25 i Kodit Penal,

*Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimii të Organizuar, mbi bazën e akteve të procedimit penal nr. 339 të vitit 2016 lë Prokurorisë Për Krime të Rënda, të përcjellë për kompelenë lëndore, me datë 20. .12.2019 ka regjistruar procedimin penal nr.29, për vepral penale “Prodhimi dhe shitja e narkoli/cëve”, “Trafikimi i narkotikëve” “Grupi i strukturuar kriminal", dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 283, 283/a, 333/a dhe 334 i Kodit Penal.*

Rezulton se Shërbimet e Policisë Gjyqësore në Komisariatin e Policisë Kavajë, kanë referuar aktet në Prokurori, lidhur me disa shtetas që dyshohej se po kryenin veprimtari të kundraligjshme në drejtim të trafikimit të lëndëve narkotike. Nga aktet e para hetimore ka rezultuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, ka regjistruar procedimin Penal Nr.552, të vitit 2016, për veprat penale “Prodhim dhe shitje të narkotikëve” parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal.

Gjatë hetimit të procedimit në ljalë, kanë rezultuar të dhëna të siguruar nga policia gjyqësore se disa shtetas, ndër ta edhe i pandehuri Astrit Balliu (alias Avdyli, Sulejmani) « merreshin me trafikimin e sasive të madhe të lëndëvë narkotike nga Shqipëria në drejtim të Italisë dhe vendeve të tjera Evropiane. Gjatë hetimit rezultuan të dhëna dhe u identifikuan persona të tjerë që merreshin me aktivitetin kriminal të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, trafikimit të narkotikëve, të cilët vepronin në kuadër të grupit kriminal.

Nga aktet e administruara, nga përdorimi i metodave speciale të hetimit, si përgjimet telefonike, vëzhgimet, si dhe nga aktet e marra nëpërmjet letërporosive, rezulton se janë dokumentuar episodet konkrete të sekuestrimit të lëndëve narkotike të llojit cannabis sativa, si gjatë prodhimit dhe shitjes së narkotikëve brenda vendit, ashtu edhe trafikimit të saj për jashtë shtetit, si dhe trafikimi i lëndëve narkotike të lojit heroinë brenda vendeve të Bashkimit Europian, nga Hollanda në Itali.

*Me datë 08.02.2017, Autoritetet Policore Italiane kanë sekuestruar sasinë prej* 1598 kg *lëndë narkotike të llojit cannabis sativa. Për ngjarjen në fjalë janë arrestuar në flagrancë shtetasit shqiptar Ermal Agaj dhe Avni Dhrami, ku është sekuestruar si provë materiale edhe mjeti lundrues me të cilin është trafikuar lënda narkotike nga Shqipëria në Itali. Rezulton se kjo lëndë narkotike është trafikuar nga dy personal e lartpërmendur për llogari të grupit kriminal si më poshtë.*

Nga hetimi ka rezultuar se ky mjet lundrues ka shkuar në rrugë detare nga Fieri në Lezhë, B ku do të ngarkohej me lëndë narkotike dhe më pas do të trafikohej në drejtim të Italisë. Duke patur dyshime se po survejoheshin dhe do të ndiqeshin nga Policia, pjesëtarët e këtij grupi kriminal, Astrit Balliu, Gjevi Ndoka, Esat Mehmeti, Petrit Sulejmani, Saimir Sulejmani, kanë 1 ( ndryshuar mënyrën e transportimit. Kështu, ata me datë 04.02.2017 e kanë rimorkuar mjetin lundrues në karrel dhe e kanë tërhequr me automjetin foristradë, tip Range Rover, me targa AA1910Y, duke e dërguar në qytetin e Fierit, ku dhe është ngarkuar lënda narkotike e sekuestruar në Itali.

Ky fakt është dokumentuar në sajë të përdorimit të metodave speciale të hetimit, siç kanë qenë përgjimet telefonike të këtyre subjekteve si dhe vëzhgimi dhe survejimi i lëvizjeve të tyre nga Forcat Operacionale Lëvizëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Shtetit.

Kështu, rezulton se disa ditë para realizimit të trafikimit të kësaj sasie lëndë narkotike, me tv datë 04.02.2017, të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli), Gjevi(Xhevahir) Ndoka, Esat Mehmeti, Petrit

[shqiptaria.com]

Sulejmani, Saimir Sulejmani, janë takuar me njëri-tjetrin në qytetin e Lezhës, kanë lëvizur në vende të ndryshme, kanë ngarkuar mjetin lundfues në karrel dhe më pas e kanë transportuar për në Fier me automjetin me targa AA1910Y.

Nga transkriptimi i përgjimit të bisedave telefonike të të pandehurve, Astrit Balliu, Esat Mehmeti dhe Petrit Suljemani, rezulton se me datë 03.02.2017, ora 08:49 i pandehuri Astrit if Balliu(alias Sulejmani, alias Avdyli), i cili në atë kohë kishte në përdorim numrin celular 0695863920, ka komunikuar me numrin 0692063196 në përdorim të të pandehurit Esat Mehmeti, i njohur me pseudonimin “Cakja” me këtë përmbajtje, si më poshtë:

*Erdhe ti./-Jo nuk erdha duhel me ardhë ti me gjithë Bushin, që të mos visha unë atje kotë duhet me ardhë ti këtëj se do ik atje poshtë bashkë. /- ca do bëj atje poshtë? /-po hajde se ashtu është një punë, o vëllai im duhet të më kuptosh edhe ti mua, vetëm do flasim u kanë mbyllur . - ato muhabete, a e kupton vëllain tatë, po hajde pak se duhet të flasim”.*

Bisedë e datës 03.02.2017 në orën 08:21:09, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Petrit Sulejmani( i thirrur Bushi) nëpërmjet numrit të telefonit 0699463534, si më poshtë:

*“920:alo, 534: urdhëro, 920: mgjes, Astrit jam, 534: mirë, si je, 920: mirë, mirë, ku është Bushi,, 534: kush je ti, 920: jam një shoku vet, 534: aaa, ja ta tja jap se jam në dhomën time, 920: mirë, 534: ooo Bush më mori në telefon njëri, në telefon dhe thotë jam shoku i Bushit, naa (në ambientale kjo pjesë), O Titii, 920: hë në gjumë vëlla, 534, eee s’ka gjë, 920: edhe unë në gjumë, , 534: ku je?, 920:jo, unë thashë të vish një cikë së bashku me atë shokun se do ikim deri atje poshtë patjelër, a më kupton vëlla, 534: aha e mirë, mirë. 920; lë jolim një cikë se ashlu jan ëca gjojna me një fjalë, a kupton, 534: ok, hajt, 920: merre dhe Caken dhe hajdeni një cikë këtej, 534: mirë vëlla, mirë, hajt, 920;hajde pra ”.*

Po ashtu rezulton se i pandehuri Astrit Balliu ka komunikuar me të pandehurin Petrit *U* Sulejmani duke i dërguar sms *“mgjes, duhet të shkojmë der në Lezh, mere dhe ate skokun me vete ”*.

Bisedë e dates 03.02.2017 në orën 08:44:54, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Petrit Sulejmani( i thirrur Bushi) nëpërmjet numrit të telefonit 0699463534, si më poshtë:

*“920: mgjes vëlla, u zgjove, 534: po, po, 920: e shif merre dhe atë shokun se duhet të jetë patjetër vllai im sot atje. Po ju pres se desha me ardh dhe unë e thashë që hajdeni dhe ju edhe ikim, a më kupton, 534: ashtu, ashtu, do e bëjmë, 920: e po ju pres në shpi, e mirë vëlla ”.*

Bisedë e datës 03.02.2017 në orën 08:44:54, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Petrit Sulejmani( i thirrur Bushi) nëpërmjet numrit të telefonit 0699463534, si më poshtë:

*“920: hë, a jeni nis vlla, 534: këtu tek lokali i Cakes jam vëlla, po ai është në një varrim vëlla, dëgjon. 920:po, 534: dhe do vonohemi një cikë se ai epo ikën për varrim, 920: e mirë pra, epo duhet me ardh patjetër se hesoi më kupton, patjetër, patjetër, 534: po të kuptoi shumë mirë, po të mbarojë punë ky dhe do ikim direkt se nuk ka problem, kur të nisem unë që ktej do të të them dhe mer tre cerek ore jam andej, 920: ok, 534: mirë vëlla ”.*

Bisedë e datës 03.02.2017 në orën 12:01:58, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Petrit Sulejmani( i thirrur Bushi) nëpërmjet numrit të telefonit 0699463534, si më poshtë:

*“920: hë vëlla, a jeni nisë ee, 534: po, po, u nis Cakja me një se unë jam në gjyq për punën e dajës e po vjen për 10 minuta, 920: mirë ”.*

Bisedë e dates 04.02.2017 në orën 09:28:14, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Petrit Sulejmani (i thirrur Bushi) nëpërmjet numrit të telefonit 0699463534, si më poshtë:

*“920:mgjes vëlla, ca bane, 534:mirë, hiç, po vijmë, rrugës jemi, 920: ka ja, 534: pothuajse në Rrogozhinë jemi, 920: epo mirë, hajde një cikë ka shpia dhe më merr dhe mua se nuk kam makinë unë e janë në gjumë njerzit, rrofsh ”.*

Bisedë e datës 04.02.2017 në orën 10:06:08, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Petrit Sulejmani (i thirrur Bushi) nëpërmjet numrit të telefonit 0699463534, si më poshtë:

*“920:he, 534; hë vëlla dil, 920: po, po ”*

[shqiptarja.com]

Bisedë e datës 04.02.2017 në orën 13:35:46, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) ‘ nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Petrit Sulejmani (i thirrur Bushi) nëpërmjet numrit të telefonit 0699463534, si më poshtë:
*"920: hë, 534: do vish me ne apo të çojnë çunat, 920: po,po, jam me çunat, 534:e mirë pastaj, hajt, mirupafshim*
Bisedë e datës 04.02.2017 në orën 1^:42:34, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Petrit Sulejmani (i thirrur Bushi) nëpërmjet numrit të telefonit 0699463534, si më poshtë:
"*920:hë, 534: ja për 10 minuta dalim, 920: a në rregull, do e merrni...534; ee, hajt, 920: mirë vëlla".*
Komunikim mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Petrit Sulejmani (i thirrur Bushi) nëpërmjet numrit të telefonit u 0699463534:
*"Sms: Tani do dalim, të marr unë satë mbarojmë".*
Bisedë e dates 04.02.2017 në orën 15:29:05, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Petrit Sulejmani (i thirrur Bushi) nëpërmjet numrit të telefonit 0699463534, si më poshtë:
*"920: hë, u nisët vëlla, 534: akoma, akoma, se tani po ngarkojmë dhe ...tek lokali, hajt, 920: e ca desk me then unme, me tokë jeni ju, 534: po, po në tokë, mirë hajt*
Bisedë e datës 04.02.2017 në orën 15:35:46, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Petrit Sulejmani (i thirrur Bushi) nëpërmjet numrit të telefonit 0699463534, si më poshtë:
*"920; hë, 534: do vish me ne apo do të të çojnë çunat, 534: e mirë pastaj, hajt mirupafshim".*
Bisedë e datës 04.02.2017 në orën 19:22:54, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Petrit Sulejmani (i thirrur Bushi) i, nëpërmjet numrit të telefonit 0699463534, si më poshtë:
*"920, ca bane vlla,534: hie, mbërritëm, mbërritëm, 920: mirëë, 534; ee, erdhëm, erdhëm, 920: me ca ikët, me tokë apo me det, 534, me tokë o vëlla, me tokë, 920: arritët ju?, 534: po, po, 920: mirë vëlla, prandaj të mora".*
Bisedë e datës 04.02.2017 në orën 19:22:54, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Petrit Sulejmani (i thirrur Bushi) nëpërmjet numrit të telefonit 0699463534, si më poshtë:
Bisedë e datës 04.02.2017 në orën 09:26:50, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Esat Mehmeti nëpërmjet numrit të telfonit 0692063196, si më poshtë:
*"920: mgjes vëlla, 196: mgjes, u nise ti, 920: jo unë nuk jam nis se thashë mos vije ti, 196: epo në Lushnje jam, fol me Bushin vëlla e të vijë e të marrë Bushi, 920: mirë vëlla, 196:fol me Bushin e të vijë e të marrë Bushi".*
Bisedë e datës 04.02.2017 në orën 14:41:45, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Esat Mehmeti nëpërmjet numrit të telfonit 0692063196, si më poshtë:
*"920: ca bane vëlla, 196: fol me Bushin se kam lëviz pak, 920; me Bushin, 196: e, fol me të, 920; hajt se po fol unë".*
Bisedë e dates 04.02.2017 në orën 14:41:45, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Esat Mehmeti nëpërmjet numrit të telfonit 0692063196, si më poshtë:
*"920: ee për 10 minuta tha ai, 196: ok, ishalla, 920: mirë, mirë se komunikoj vetë unë me ala, se komunikoj n dry she me ta, 196, hajp".*
Më datë 04.02.2017, ora 15:30, i pandehuri Astrit Balliu (alias Sulejmani, Avdyli), me numrin celular 0695863920, komunikon me të pandehurin Petrit Sulejmani, i njohur edhe me i pseudonimin "Bushi", që kishte në përdorim numrin celular 0699463534;
" *- Do të vish me ne, apo do të cojnë çunat./-Po, po jamë me çunat.* "
Me datë 04.02.2017, ora 19:21, ndërmjet të pandehurit Astrit Balliu(alias Sulejmani, Avdyli), me numrin celular 0695863920 dhe të pandehurit Petrit Sulejmani, i njohur me pseudonimin "Bushi", që kishte në përdorim numrin celular 0699463534, kanë rezultuar të dhënat, si më poshtë:
" *Çfarë bënë o vëlla. /- Erdhëm, erdhëm. /-Po me çfarë ikët, me tok apo me det, a arritët? /-po me tok, po. /Prandaj të mora ".*

[shqiptarja.com]

Bisedë e dates 07.02.2017 në orën 19:29:49, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Esat Mehmeti nëpërmjet numrit të *i* telfonit 0692063196, si më poshtë:
*“920: mirëmbrëma, ca bëre vëlla, 196: mir ca bën ti, 920: mirë valla, për qef të mora, 196:ca bën ti, 920:vetëm mirë, rrijmë ca do bëjrnë, ca bëhet, 196: mirë bëre që more them, se mos janë afruar ndonjë letër, ndonjë gjë se jam keq fare, 920:të kuptoj perfekt, 196: mirë vëlla, 920: do të kthej një përgjigje nesër, në rregull vëlla, 196: mir, hajt se do flasim, 920: në rregull vëlla,ju mora me jupyet vetëm sijeni me shëndet, 196: rrofsh vëlla, 920: pa merak vëlla”.*
Nga përgjimi i bisedave telefonike të bëra mes të pandehurve Astrit Balliu( alias Avdyli, Sulejmani) dhe të pandehurve Gjevi(Xhevahir) Ndoka, Petrit Sulejmani dhe personave të tjerë, kanë rezultuar të dhënat si më poshtë:
Me datë 19/01/2017, ora 16:15:31, i pandehuri Astrit Balliu, nëpërmjet numrit celuar të tij 0695863920, është telefonuar nga i pandehurit Gjevi Ndoka, që ka në përdorim numrin 0686077760, me përmbajtje si më poshtë:
*“760 : Astrit,... ça bone ?! 920 : Hëë.. ? 760 : Ku je , ke ardh në Lezhë ?, 920 : Vallahi..., po po kam ardh në Lezhë... 760 : ..te Turizmi mbas 15 minutash...3920 : ... aaa unë jam,...po vij pas 15 minutash..? 760 : Mbas 15 minutash te Turizmi..., e di Turizmini ti ,920 : E mirë, kur të jesh aty më thirr... 760 : ...hajt ok”.*
Bisdë e datës 21/01/2017, ora 12:35:52, mes të pandehurit Astrit Balliu me numër telefoni *0695863920 dhe të pandehurit Gjevi Ndoka me numër 0686077760, si më poshtë:*
*“920 : ça bone?, 760 : ...mirë, si kalove ti ?, 920: mirë vallahi..., tu nejt në shtëpi...!, 760 : ..Sa ditë e mirë sot, mor burrë ! .... Të them unë pa merak se po shof..!, 920: Nesër do vij unë , se mos dal njëherë me nusen... ”.*
Bisedë e datës 22/01/2017, ora 10:35:12, mes të pandehurit Astrit Balliu me numër'i telefoni 0695863920 dhe të pandehurit Gjevi Ndoka me numër 0686077760, si më poshtë:
*“760 : ...Hë Astrit..?, 920 :... Ça bone,...hiç, tu ardh jam !, 760 : ...mirëardhsh".*
Bisedë e datës 23/01/2017,ora 18:34:57, mes të pandehurit Astrit Balliu me numër telefoni 0695863920 dhe të pandehurit Gjevi Ndoka me numër 0686077760, si më poshtë:
*“920 : ...Hëë.. ça bone o rob Zoti..?, 760 : ....Mirë, ça bone ti, si kalove ? Hë ça ka ndonjë të re? 920 : ....Asigjo, po rrimë, 760 : ..S’e takova atë që të thashë, nuk erdhi...!, 920 :.. A të vij nesër të takoj njëherë unë ty..? Po vij nesër nga mëngjesi, 760 : ..hajde kur të dush, hajde, 920 : ...paradite 2 minula, a më kupton,...për atë që të thashë..! aaa unë, jam,...po vij pas 15 minutash..?, 760 : .. hajde, hajde, 920 : ..A e ke telefonin atyyyyy.... 1 ?, 760 : ...Jo s’e kam, po hajde”.*
Bisedë e datës 24/01/2017, ora 09:51:34, mes të pandehurit Astrit Balliu me numër telefoni 0695863920 dhe të pandehurit Gjevi Ndoka me numër 0686077760, si më poshtë:
*“920 : ... ça bone, vallahi tu ardh jam, 760 : ....Mirë, hajde te puna këtu përballë punës, 920 : ....Te ai lokali në kat të dytë, atje apo..?, 760 :.... po. Po, bravo*
Bisedë e dates 24/01/2017, ora 11:48:50, mes të pandehurit Astrit Balliu me numër telefoni 0695863920 dhe të pandehurit Gjevi Ndoka me numër 0686077760, si më poshtë:
*“920 : ... ça bone vëlla, ...këtu është Beni te Sandri e po pijmë një kafe,..aje tu ardh ti këtu ?, 760 :.... Jo, jo ..vazhdoni ju...920 : ....Beni osht këtu me një fjalë,...unë po lëviz, 760 :.... Ben Shkodrani...???, 920 : ....Po, 760: ....A po m’ja thu ti e mbylle ti me të, ...se kam këta e sa të rrijë me këta pak, 920 : ....mirë,...fola unë pak., 760 : ....Ok, mbajmë tak. me ty i thuaj-.., shkruajm aty...l Hajde pra,je, gjigand”.*
Bisedë e datës 25/01/2017, ora 09:43:00, mes të pandehurit Astrit Balliu me numër telefoni 0695863920 dhe të pandehurit Gjevi Ndoka me numër 0686077760, si më poshtë:
*“920 : ... ça bone, si kalove..?, 760 : .... aaa si kalove,... sa ta nis unë se s'e kam marrë pasha Zotin,...harrova, mbrëmë e sot ta nis shoku jot se nuk ia mora vëllait mbrëmë.... sa ta marr e ta nis ! Deri në darkë, ta nis, 920 : ....Deri në darkë ëëë ?! 760 :.... Po ”.*
Komunikimi me SMS me datë 28/01/2017, ora 1 1:58:53, mes të pandehurit Astrit Balliu me numër telefoni 0695863920 dhe të pandehurit Gjevi Ndoka me numër 0686077760, si më poshtë:
**“920-sms-:** *Ça ubovëlla,... me moren ato Jieraket!”.*
Bisedë e datës 06/02/2017, ora 19:13:51, mes të pandehurit Astrit Balliu me numër telefoni 0695863920 dhe të pandehurit Gjevi Ndoka me numër 0686077760, si më poshtë:

[shqiptarja.com]

*"760 :.... ça po bon..?, 920 :... eee nuk po më mbulon telefoni, se desh me të..., mu ka prish, mu ka mbaru, karta..!! Tashi, po ashtu i thuj një çikë Kujtes (Kujtimi) të ma çoj kartën me mesazh,.. e porosit atje Vodafon, 760 : ....Ok, se po i them unë, 920 : ....eee jam me menaxherin e Shijakut, në Durrë,.. menaxher sporti, Atinin..!, 760 : .... Mirë pra vëlla, po i them unë atij..!, 920 ....Shife pra, thuj kështu keshtu,... se doja me fol me të se kisha dhe një muhabet me atë Kujtimin,... ma ashtu një kartë vodafon ".*
Komunikim me sms me datë 07/02/2017, ora 08:52:09, mes të pandehurit Astrit Balliu me numër telefoni 0695863920 dhe të pandehurit Gjevi Ndoka me numër 0686077760, si më poshtë:
*"760 -sms-: ....100266534956079 (numër i dërguar nga Kujtimi!)*
Bisedë e datës 07/02/2017, ora 11:37:51, mes të pandehurit Astrit Balliu me numër telefoni 0695863920 dhe të pandehurit Gjevi Ndoka me numër 0686077760, si më poshtë:
*"920 : ... pooo..?, 760 : .... tha Kujtja,.. a po vje e më takooo ???, 920 : ....Po, direkt, 7760 : Lidhu me të, ok"*
Bisedë e datës 07/02/2017, ora 12:56:03, mes të pandehurit Astrit Balliu me numër telefoni 0695863920 dhe të pandehurit Gjevi Ndoka me numër 0686077760, si më poshtë:
*"760 : ....eeej,... a s'e ke rregu/lu telefonin^.. më tha..?i 920 :... S'e kam rregullu.., po ja sa do ta takoja dhe ja do e rregulloj !!!, 760 :.... foli në telefon më tha,... se i doli një pune dhe po bën rrugën për Kashar!, Më prit te lokali -tha...! Në Kashar te lokali i vet. Sa ti bëjë rruga, 920 : ....Po, në Kashar te lokali i vet. Direkt".*
Komunikim me sms me datë 16/02/2017, ora 11:48:07, mes të pandehurit Astrit Balliu me numër telefoni 0695863920 dhe të pandehurit Gjevi Ndoka me numër 0686077760, si më poshtë:
*"920 -sms-: Si jeni kto firaket me kan mar vlla ca do bejme.*
Komunikim me SMS me date 16/02/2017, ora 11:48:43, mes të pandehurit Astrit Balliu me numër telefoni 0695863920 dhe të pandehurit Gjevi Ndoka me numër 0686077760, si më poshtë:
**"760 -2 sms-: Shife....Te shkrujta".**
Bisedë e datës 10.03.2017 në orën 20:11:11, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Esat Mehmeti nëpërmjet numrit të telfonit 0692063196, si më poshtë:
*920: hë Cake, 196: ca bën vlla, 920: hë vëlla, tu nejt ca të bëjmë, ca bëhet, 196: mirë jam mirë, 920: nigjo, thuaj atij shokut se mu ka maru ajo karta ngaqë e kam të huaj e ta dijë e të më mori këtu, kur të vijë knej, 196:aa, 920: mu ka marukarta e telefonit që merrem vesh unë me Mirin, them, 196:po, ee, 920:që ta dish them e të më marr këtu, 196:ok, ok, 920: se më ka maru sot dhe mund ta karikoi nesër ose pasnesër, a më kupton, 196: ok vëlla* **".**
Bisedë e datës 10.03.2017 në orën 20:11:11, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) nëpërmjet numrit të telefonit 0695863920, me të pandehurin Esat Mehmeti nëpërmjet numrit të telfonit 0692063196, si më poshtë:
*"920: hë Cake, 196: hë vlla ca bën, 920:ca po bën, 196:mirë, 920: thuaj ashtu i cikë ai shoku, 196: është në Tiranë ai, 920:ee, 196: është në Tiranë, 920: po pra, po, i shkruajta po s'është ashtu, 196: është në Tiranë, 920; po pra po, s'po ashtu ai, thuaj që të më ashtu mua ai, 196:ok".*
Bisedë e dates 02/01/2017, ora 08:53:49, mes të pandehurit Astrit Balliu dhe personit tjetër që përdor numrin 0694706350, si më poshtë:
*"920: Mgjes, 350: Miremengjesi, 920: Ca bane ?, 350: Hie mire ne Tirane jam, 920: A mire pra, po vi te ta/coj, 350: Ska problem, a bane noj gja te mire, 920: Hajt se vi e te takoj atje o rob zoti 0694706350: Mire pra.. ca bat me ate qe eshte atje te Gjevi, 920: Erdhen... do vi te takoj atje o rob zoti.., 350: Mire hajde ".*
Bisedë e datës 05/01/2017, ora 10:56:43, mes të pandehurit Astrit Balliu dhe personit [1] tjetër që përdor numrin 683694726, si më poshtë:
*"920: He Rame ?, 726: Ckemi ore. Sem more mrame ti muve e spata oferte mrame, 920: Erdha vone o Rame, pasha zoten erdhe vone, 726: A nejte me ta?, 920: Nuk nejta me ta se te Shtunen vjen Xhevi, ishte jashte shtetit ngaqe eshte tu ba ate vitin e Ri, edhe e presin. Ca bahet?, 726: Hie per zotin hie , 920: Mos u merzit, kur ke prit kaq prit edhe pak dite..., 726: Po jore skena ca te bajme , Ka je , En Fushe Kruje jam, 920: Hajte pra ngjohena pa merak... "*
*Bisedë e datës* 05/01/2017, ora 12:50:23, bërë mes të pandehurit Astrit Balliu dhe personit tjetër me numër telefoni 0695393180:

[shqiptarja.com]

*“180: He Titi ca bane, 920: He te bezdisa ni cike en telefone e?, 180: Ca je tu than ore , 920: Jam nje cike kshu une. Neser ne oren 12 e kemi lane me u taku te lokali jot me ate, 180: Shum bukur Titi... hame dicka bashke neser en dreke e pastaj levizi me ata..., 920: Ne rregull. A foie me ato shok, noj gja e mire a noj ashu , 180: Per zotin o Titit gjitheka ka ngel te pjesa e Anglezve o Titi,920: Eheh, 180: Ala sna kan kthye pergjigjen , 920: T'kuptova. Ok lakohena neser edhe flasim, 180: Ok Titit pa merak, 920: Hajde o rop zoti”.*
Bisedë e dates 08/01/2017, ora 19:44:43 bërë mes të pandehurve Astrit Balliu dhe Gjevi Ndoka, si më poshtë:
*“920: Ku je o rob zoti, 760: Ne Shqiperi, kam ardhe, 920: E mora vesht se ke ardhe, 760: U lodha, em lodhen rruget, 920: Nga i re knej nga Koracia aaaa?, 760: Erdha nga Kroacia por isha edhe ne France e u lodha, 920: Pupu i forte je, 760: Po i kam .... ropt.... po shifna tash, ktej jam une, 920: Une, neser me ke aty, 760: Mire ardhesh, 920: Neser em ke aty* **”.**
Bisedë e datës 09/01/2017, ora 10:45:29 bërë mes të pandehurir Astrit Balliu dhe personit tjetër që përdor numrin 0694706350:
*“920: Nga je ?, 350: Une jam ne Tirane, mos leviz e shkoj per Mirdite, 920: Ku mundet te takohemi se sa te takoj nje cike ate shokun kelu “ne Lezhe... ” e do kthehem se nuk do rri shume. Pune 10 minutash kam..., 350: Mire, edhe mos mem takue nuk eshte problem, 920: Une te kuptoj, po desha me te takue vete une..., 350: Me keta nuk bahet gja, me kete te dyten e..., 920: Presim se eshte cdo gja ne r re gull se i kemi dhan ato, vetem sa te ulen nje cike keto kohet, 350: Mire figure hajde cao cao, 920: A kupton ? ”*
Bisedë e datës 09/01/2017, 18:17:00, mes të pandehurit Astrit Balliu dhe personit tjetër që përdor numrin 0695277333:
*“920: Ti ca bane noj gja?, 333: Asigja kam qen gjith diten ne shpi sot. Isha keq mram, tashi masdite dola nje cike, 920: A bane gja me ate shokun a jo..., 333: Nuk ka ardhe akoma, 920: Ka asht ne Dardhe a Mai te zi a, 333: Ne Mai te Zi anej ashl. Eshte e sigurt se ate dite qe do ikte me tha me duhen nja 1000 Lek se do ikte. Ca bane sot?, 920: Hie verdal anej nga Lezha nga Kavaja asgja.... (bisede pa interes...), 333: Ca bane noj gja tjeter , 920: Asigja vlla, duke nejt duke prit. Ca me te than, do bahena gadi avash avash, pune ditesh e me levize, 333: Duhet me levize, 920: Presim te takojme ate shokun e ca qysh tek e me levize. Pune ditesh, e kupton vllain late, shkojme e bajme noj pune a noj gja anej, 333: Mire vllai, 920: Rrofsh nigjohemi”.*
Bisedë e datës 10/01/2017 ora 15:57:37, mes të pandehurit Astrit Balliu dhe personit që numrin e telefonit 0684835668:
*“920: Mori edhe ne Holland ashu (bisede tavoline)...668: He gjigande..., 920: Per anej siper se harrova me te than, ca do bahet per punen e librit...?, 668: Ka me u ba verem ngaqe sashu, u kap ai Shqiptare atje... edhe po thone se mos u ashu, edhe po thon se nuk don me ashu, mos me diskutu fare ato...si te shkojme anej nga zona anej. Te rrim masanej nga Hollanda.. Masanej te shohim ca po bahet ?, 920: Ashu po e bajme, vetem ashu i ka mbet me nje fjale..., 668: Si te themi se jemi afer masanej, 920: Mire pra rop zoti se nigjohena pra... ”*
Komunikime të datës 10/01/2017, 17:01:46, mes të pandehurit Astrit Balliu dhe personit tjetër që ka në përdorim numrin celular 0695393180:
*“SMS Text: vella ikom shrujt aty shokut anglezt 100 duan sdi qat baj ai sme pergjigjet neser asht rruga lekt ikan angli ijapin para”.*
Biseda telefonike të të pandehurit Astrit Balliu me përdoruesin e numrit të telefonit 0695393180
**“** *Sms Text: tha na lat Irruge* **”**
*Biseda telefonike të lë pandehurit Astrit Balliu me perdoruesin e numrit të telefonit 694706350 (Petriti nga Kaçinari), me datë 28/01/2017 18:18:17, si më poshtë:*
*“920: Do vi le lakoj, ku je ti?, 350: Une jam ne Tirane, ku je ti?, 920: Sonte spo le them jo, por nga e Hanapo ashu..., 350: Mire, 920: Fjale te mira kena,jo shum te mira, por nje 40% jena deri dikun, 350: Mire more, baj ca te duesh ti..., 920: Jo pa merak, e dim te gjithe, jena te gjithe me letra te hapme e din vele..., 350: Ca bane me kta..., 920: Me kte nuk kam foie, por me ate jena ne rregull. Kemi ca firo por do flasim..., 350: Mire, 920: Jam ne rregull me ate te parin e ke parasyshe, 350: Sa te mundesh se ti e din si e kam hallin e problemin.., 920: O vllai im ja kam than qe ate dite qe erdhi se ishin te gjith njerzit se en dac me me respektu do me respektosh ketu... 350: Po mire se te merzita edhe ty duke ti ra telefonit, 920: Jo jo edhe ai asht ne rregull e na din per faleminderit 100 here, 350: Mire Astirit mire ’’.*

[shqiptarja.com]

Biseda telefonike të të pandehurit Astrit Balliu me të pandehurin Gjevi Ndoka, me datë 10/02/2017, ora 10:30:17:

**"***350: He mo Astrit, 920: Ca bane ...?, 6350: A e takove Gjevin a gja...? , 920: Jo se kam taku me than te drejten se kam takue, po pres me takue o sot o neser, keto dy dite me nje Jjale., ti pa merak me një fjale* **…** *350: Takoje nje here takoje ..., 920: Pa merak o miku im pa merak, te kuptoj shum mire... ".*

Biseda telefonike të bëra nëpërmjet numrit të të pandehurit Altin Avdyli 55698967765, me përdoruesin e numrit 697663178, me datë 16/02/2017 17:36:56, si më poshtë:

*"765: Alo a je tuj em nigju...?, 178: Tashi nigjohesh ma mire, 765: Nigjo a e din si e kam hallin?, 178: He fole, 765: Kte te ktujten, (drogen e Shqiperis...) en Shqiperi e kam aty ne Ishull. Ca bahet?, 178: E ke ktu?, 765: Jo e kam atje ku rrin ata shokt e tuej, 178: Ne Angli?, 765: Po, 178: Po shum bukur a e ke cue vete ti, a eshte e joti?, 765: Asht e nje mikut tim, ma ka dhan me më ba ner o vlla, 178: Si ta kete dhan ty, ma jep mu nuk asht problem, 765: Jane 500 mi Leke.., 178: Po shum bukur. A te bjen gja ty zerma. A te bjen gja ty aty?, 765: Po po. Bjen edhe jam mire, a me kupton. Pranej po te them une ty. Cfare numri ke ti aty edhe me em ba mue ner. A e kupton? Ma ka ba me em ba nere, po duhet komplet em tha mue ai, 178: A ka noj numer ai atje?, 765: Po po kishin cdo gja, jan ne rregull, 178: Ma co ni numer, 765: A e marojme ate, edhe ai ishte shum ne rregull. Ai ma la mue me 1700 te ati venit atje (te Anglis). Ma la mue me m 'ba ner. Per ty em tha mue. I thash une e dum te gjith. Tashi ca munesh. Jane 500 a me kupton Euro, 178: Isha me nje shokun lane qe e ke pas ortak perpara. Si e ka emnin, ai kishte pas nja 400 shok si e ke ti ktu... A ke ma muhabet ti me ta, me Landin?, 765: Une kam muhabet po s 'kam kontakt, 178: Latfi a si e ka emrin. Ja merrsha me 1300 e cojsha per veti, 765: Po per ate qe eshte aty ca bahet, eshte shum i mire, 178: Ja marrim atit me 1700 a em kupton... i thona t 'na e bjer fix a kupton? Problemi asht se asht ma mire kur e marrim ktu me 1300 e na shkon 1300 Paund atje edhe i cojme 400 kile edhe i bjen dmlh lekun en dore. Rrugen e kemi, 765: Mire mo po ai don me em ba mue ner, a je vlen a s'ja vlen, a me kupton. Po s'ja vlejti po i them s'bahet edhe kaq, 178: Si çmim ta ka lane mire fare nuk diskutohet, 765: Edhe me garanci se thot eshte kshu si te them une. A kupton?, 178: Per lek a na pret naj dite ai, 765: Po po, si te thuesh ti nuk asht problem. Per sa dite, per 20 dite? ".*

Biseda telefonike të bëra nga i pandehuri Astrit Avdyli nëpërmjet numrit në përdorim të vëllait të tij, Altin Avdyli, 355698967765 (flasin edhe persona të tjerë qe janë me Astritin...), me përdoruesin e numrit celular 697663183, me datë 16/02/2017, ora 20:48:47, si më poshtë:

*"183: (/let nje person tjeter..) Ckemi si e kalove, 765: Ketu jem vlla, si e kalove. Ktu jemi po pijme nje kafe me keta shoket e tu vlla. Degjo vlla a shkon dot sonte ne Harrou te takosh ate cunin tim?, 183: Po, por e mora ne telefon ate çunin atje, 765: Po por nuk dinte gje ai se ti nuk j a kishe zen emrin tim ne goje. Tani ai e din. Per nje ore, sa eshte ora tani? Shiko sa eshte ora tani aty te ty, edhe për një orë do e takosh aty robin tim vlla edhe merri kalamjt e coj ne kopesht neser (me marre drogen), 183: Ok ne rregull vlla. Sonte ka shku nje cike vonë, 765: Ose shko sonte ose neser kur te kesh kohe. Ca te thon keta shoket e tu ketej, ti shko e merri edhe e din vete ca do besh vlla, me kupton vllain, 183: Pa merak vlla, mos e ki merak ate pjes, 765: Ok vlla, nese nuk shkon dotë sonte neser pas orës gjashtë të darkës vlla, 183: Ok vlla te kuptoj, nuk ka gjë se është në punë..., 765: Ok vlla. Natën e mirë nga mua, na e foli shokut tende e rrespekte nga mua. (flet ne telefon Astriti...) He vlla ca bane? Me Isakun jemi tu pi një kafe edhe..., 183: Kur do vish ktej..., 765: Pune ditësh o vlla... do vi do vi. Sa mundet të vonosh ti se jam me këto shokët edhe jan tuj na e ba per nere, per mua kto, a e kupton vllain tane?, 183: Me degjo mua, une do baj maksimumin e kto do dalin shum te knaqem. Une mora barin neser..., 765: Them per sa munde te ashu ti (per sa mundet të paguash ti) se ai eshte ok eshte i sigurt ?, 183: Shum shpejt Titi, neser do i jap 300.000 (treqinde mije) Paund. Neser e mora barin do ju dorezoj 300.000 paund, 765: Ok mire. Ok vlla, 183: I maroj kshu ekspres gjanat..., 765: Ok vlla vetem shko e shife një here e hajt, 183: Ok vlla, ju pas ba mire kajja. Neser nga ora gjashtë do coje njeri atje..., 765: Ok vlla neser.., 183: Po, 765: Ok vlla, foli dy llafe Isakut..? (flet Isaku...). Alo o zemra e dajës, 183: Ca je tu ba..., 765: Ja tuj u sjedhe, 183: Pune o daje, na q... nanen puna.., 765: Shyqyr o dajë... Niçja do vije anena, do vije lartë...l83: Ca je tu ba noj sen?, 765: Hie asgja po merrem me patenten mos po ma japin sot a neser...*

[shqiptarja.com]

Biseda e date 17/02/2017, ora 19:50:37, bërë nga të pandehurit Astrit Balliu (Avdyli) dhe vëllai i tij, i pandehuri Altin Avdyli me numrin e telefonit 0698967765, me përdoruesin e numrit të telefonit 694515849, si më poshtë:
*"849: Pershendetje a foie me ata cunat... (personi flet nga Belgjika dhe ka dialekt te folure nga Kosova...), 765: Po ktu i kemi, na foli... (flet një person me dialekt nga Vlora...) Pershendetje vlla. 849: Ca bane si e kalove..., 765: Hie vlla jam me keta miqet e mi, qe jane shoket e tu... Me Astritin dhe hengrem pak buke edhe ty po presim, 849: A do folni me shokun tuj andej se neser do shkoj ne Angli me marre ate muhabetin..., 765: Po mo vlla gadi jam, por ty po presim. A ke facebook qe te flasim pak o vlla qe te jap edhe adresen tim, ku do vish ti te shkosh neser. Edhe Titi donte te dinte, se po jlas ne emer te shokut tende e te shokut tim. Donim te dinim sa dite na vonon edhe sa je ne gjendje neser. Pa u ven ti ne siklet, sa e ke mundesin ti neser? Edhe sa dite duhet te pres una? Ose sa do te presim, a e kupton yllai?, 849: E marr barin neser dhe 300.000 (treqind mije) paund ti coje neser..., 765: Edhe nje here vlla se ke edhe muzik aty, ma perserit edhe nje here. Me nje fjale nese e takon robin tim neser (e merr drogen...) edhe sa dite me vonon mua?, 849: 300.000 paund, ti jap ne dore dhe per dhjet dite ti jap ne dore te tjerat.., 765: U bë vlla, se ky shoku jot më ka thën se kur thua ti se leviz as topi. U bë vllai se ka thën edhe shoku jot. Unë dua të më jepni emailin tende o vlla, që të flasim bashkë aty, që të jap edhe adresën time ku do shkosh neser, 849: A ke skype?, 765: Unë kam po doja të më dergoje edhe adresën tënde aty edhe flasim aty, 849: A po ma con ti mua më mirë këtu?, 765: Po nuk doja ta dergoja ketu e kupton vllain? Po ashu bli një alo të ri e do blej edhe unë e ma dergo aty tëndin. Edhe të dergoj unë direkt aty ftes për një orë. Coje me anë të Tiranësit o vlla. Foli vlla.. (ja jep telefonin Astritit...) Çoje te Tiransi vlla, po coje direkt te kompletuem. Se e kam ketu en PIN atë...849: O Titi, degjo vllain. A janë 500 kile aty o vllai..., 765: Po, 849: Ok nesër i kam gadi Anglezët që do e marrin edhe do flasim bahskë me email aty..., 765: Kur do ma çosh numrin?, 849: Tashi en sekond..., 765: Ok pa merak, u bë çdo gje en rregull. E kupton vllain tat. Është ajo që duhet, ajo aty, është ajo që duhet.. ".*

Bisedë e bërë nga i pandehuri Astrit Balliu( Avdyli) nëpërmjet numrit celular të vëlliat të tij, Altin Avdyli, 698967765, me përdoruesin e numrit celular 0693888025, me datë 17/02/2017, ora 21:06:02, si më poshtë:
*"(bisede ambientale, flet personi nga Vlora i cili kishte drogen në Angli) Shko dhe bli një telefon te ri e dergoja me mesazh at it se na merr ne qafe o vllai. Past ta dergosh hille telefonin o vllai... Astriti i flet: Po jo o vllai pa problem...* **"**
Nga të dhënat e administruara nga policia gjyqësore, nga monitorimi i dinamikës së lëvizjeve të skafit "Perla 1761", që ka lëvizur nga Lezha në drejtim të fshatit Qarr të Fierit, janë evidentuar nga policia gjyqësore lëvizjet e këtij skafi si dhe të shtetasve dhe lidhjeve të tyre për përfshirje në funksion të këtij trafikimi, në mënyrë kronologjike nga data 04 deri më 06 shkurt 2017, kanë rezultuar të dhënat si më poshtë:
*Me datë 04.02.2017, në orën 15:20, nga ana e policisë gjyqësore është konstatuar automjeti me targa AA 191 OY dhe rimorkiatori me gomonen "Perla" mbrapa këtij automjeti, i cili ka udhëtuar nga Lezha për në fshatin Qarr të rrethit Fier. Në drejtim të automjetit A A 191 OY ndodhej shtetasi Petrit Sulejmani dhe një shtetas tjetër në vendin e parë të këtij automjeti. Intenerari i lëvizjes së këtij automjeti ka qenë nga Porti i Shëngjinit Lezhë për në Vorë -Durrës dhe më pas në fshatin Qarr, Fier, ku në orën 22:40 të datës 04.02.2017 është parkuar mjeti lundrues së bashku me mjetin karrel para një ndërtese.*
Nga hetimi ka rezultuar se mjeti tip foristradë Range Rover, me targa AA 191 OY, që ka tërhequr mjetin lundrues nga Shëngjini, Lezhë për në fshatin Qarr Fier, është drejtuar nga shtetasi Petrit Sulejmani ( i thirrur Bushi), lidhje shoqërore e të pandehurit Esat Mehmeti. Gjatë verifikimeve të kryera nga policia gjyqësore ka rezultuar se në afërsi të vendit ku ishte parkuar mjeti lundrues në fshatin Qarr, janë konstatuar me datë 05.02.2017 disa automjete, të cilat kanë lëvizur në rrugicën ku ishte parkuar mjeti lundrues në fshatin Qarr, Fier, konkretisht automjeti tip furgon me ngjyrë të bardhë më targa AA 489MU, automjeti me targa AA 919 OB dhe automjeti me targa AA 417 FC, automjeti me targa AA855 JG dhe disa automjete të tjera. Nga hetimi rezulton se mjeti me targa AA9190B, është i regjistruar në emër të shtetasit Artur Bashkim Meto. Gjithashtu është konstatuar me datë

[shqiptarja.com]

06.02.2017, se drejtuesi i automjetit me targa AA955JG ka patur dy persona në automjet, i cili ka lëvi^ur nga fshati Qarr, Fier, në afërsi të vendit ku ishte parkuar mjeti lundrues deri në qytetin e Fierit. Nga të dhënat e policisë gjyqësore rezulton se drejtuesi i këtij mjeti, në prani të të pandehurit Petrit Sulejmani është takuar me të pandehurin Esat Mehmeti, i cili drejtonte automjetin tip Porche, me targa MO 818, (që rezulton se ky automjet është traguar më pas me targa AA323 PE në emër të të pandehurit Esat Mehmeti).
Nga hetimi rezulton se mjeti lundrues “Perla” (JOKER CLUBMAN 28), rezulton i regjistruar në emër të shtetasit Klajdi Meto. Nga dosja e regjistrimit të këtij mjeti lundrues rezulton se me kontratën e shitblerjes të datës 11.05.2016, mjeti lundrues me karakteristikat: të markës YAMAHA Y F225AETX/JOKER CLUBMAN 28, me numër matrikuli 69J-1005786, viti i prodhimit 1999, është shitur nga shtetasi Adriano Isuf Jaho tek shtetasi Klajdi Saba Meto. Nga deklarata doganore e këtij mjeti lundrues të datës 08.04.2016, ky mjet rezulton me këto të dhëna: marka JOKER BOAT, modeli CLUBMAN 28, gomone e përdorur 8.5 MT, viti i prodhimit 1999, me dy motorr YAMAHA me fuqi 225 CV. Sipas dokumentacionit të kësaj dosje, rezulton se ky mjet lundrues ka numër shasie IT-AIE T2211A303,

Gjatë hetimit të këtij procedimi penal ka rezultuar se shtetasi Adriano Jaho, ka futur nëpërmjet detit në territorin e Republikës së Shqipërisë mjete lundrues të paregjistruara. Nga aktet e administruara rezulton se me datë 15.12.2016, **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë** ka regjistruar procedimin penal nr. 883 për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror, në ngarkim të shtetasit Fabjon Adriano Jaho. Gjatë hetimit të këtij procedimi penal rezulton se është sekuestruar një mjet lundrues gomone me dy motorr 250HP MERKURI, të cilën shtetasi Fabjon Adriano Jaho e kishte futur nga Italia në Shqipëri në mënyrë të paligjshme nëpërmjet detit dhe të paregjistruar tek organet kompetente.
Në vijim të hetimit janë administruar aktet e procedimit penal nr.2488 të vitit 2016, të **Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë,** në ngarkim të shtetasit Adrian Jaho, për veprën penale të kaiimit të paligjshëm të kufirit shtetëror dhe falsifikimit të dokumenteve. Nga aktet e këtij procedimi penal rezulton se me datë 16.12.2015, janë kapur në flagrancë nga policia kufitare shtetasit Adriano Jaho dhe Avni Dhrami, të cilët drejtonin një mjet lundrues me mbishkrimin JOCKER BOAT CLUBMAN 28, me **ngjyrë të bardhë** dhe më një shirit blu anash përgjatë turbolarëve, me dy motora YAMAHA, me ngjyrë gri, me fuqi motorike 2 X 225HP, secili, më të dhënat e motorëve FL225AET69K001547R dhe F225AET69JX1005786Ç, në pjësen fundore të këtij mjeti lundrues është i gjetur i montuar me vida në një pllakë metalike numri i shasisë **T2211A303.** Nga verifikimet e bëra nga policia gjyqësore, ka rezultuar se këtë mjet lundrues, shtetasit Adriano Jaho dhe Avni Dhrami e kanë futur në mënyrë të paligjshme nëpërmjet detit nga Italia në Shqipëri.
Në vijim të veprimeve hetimore, janë administruar nëpërmjet letërporosisë **aktet e Autoriteteve Italiane të Drejtësisë,** për faktin e arrestimit në flagrancë të shtetasve shqiptar Avni Dhrami dhe Ermal Agaj, me datë 08.02.2017,si dhe sekuestrimin e sasisë prej 1598 kg lëndë narkotike e llojit cannabis sativa, e ndarë në 79 pako. Nga këto akte rezulton se kjo lëndë narkotike është trafikuar nga Shqipëria në Bari, Itali me mjetin lundrues JOCKER BOAT CLUBMAN 28, me dy motora YAMAHA, me fuqi motorike 2 X 225HP secili.
Nga verifikimet e bëra nga **Autoritetet Italiane,** ka rezultuar se mjeti lundrues me të cilin u trafikua lënda narkotike është i markës JOKER BOAT, lloji CLUBMAN 28, me ngjyrë gri të hapur me një shirit blu që shtrihet në të gjithë gjatësinë e saj, me gjatësi 8.5 metër, me dy motora YAMAHA, prej 225 HP secili, me numra përkatës F225AET69J1005809 motori i djathtë dhe FL225AET69K1000285 motori i majtë. KY'mje lundrues nuk rezulton të ketë numër identifikimi shasie të tij.
Gjatë veprimeve hetimore të kryera në kuadër të procedimit penal nr. 38 të vitit 2017 (bashkuar me procedimin penal nr.339 të vitit 2016) rezulton se janë grumbulluar të dhëna për faktin se një mjet lundrues me ngjyrë lë bardhë dhe një shirit me ngjyrë blu në të gjithë pjesën gjatësore të tij, me mbishkrimin “Perla 1761”, JOCKER BOAT CLUBMAN 28, ndodhej në Portin e Shëngjinit Lezhë dhe do përdorej për trafikim lëndësh narkotike. Nga të dhënat e administruara me datë 26.01.2017 nga policia gjyqësore, ky mjet lundrues kishte një gjatësi prej 8.5 metra me dy motorë, me kapacitet mbajtës deri në dy ton, me ngjyrë të bardhë dhe me një shirit blu në të gjithë pjesën e tij, i regjistruar në emër të shtetasit Klajdi Saba Meto.

[shqiptarja.com]

Në bazë të procesverbalit të këqyrjes së mjetit lundrues me vendndodhje Qarr, Fier, me datë 24.09.2019 ka rezultuar ky mjet lundrues i parkuar pranë banesës së shtetasit Klajdi Saba Meto. Mjeti lundrues është me ngjyrë të bardhë, me shirit blu në të gjithë pjesën gjatësore të saj, me mbishkrimin JOKER BOAT CLUBMAN 28, në afërsi të saj një stemë katrore me mbishkrimin “UE”me ngjyrë blu, pa motora por rezulton të kishte vend për montimin e dy motorave, pa numër identifikimi të shasisë së tij. Mjeti lundrues në pjesën anësore të saj, mbi pjesën e veshjes ka të shkruar “Perla 1761”.
Nga përgjimi i bisedave telefonike të të pandehurve Saimir Sulejmani dhe Esat Mehmeti, kanë rezultuar mosmarrëveshjet e tyre në lidhje me pazaret e bëra për blerjen e lëndës narkotike. Konkretisht rezulton se gjatë kësaj kohe i pandehuri Saimir Sulejmani ka përdorur numrin celular 0697498051 dhe i pandehuri Esat Mehmeti ka përdorur numrin celular 0695764588.
Bisedë e datës 25.03.2018, ora 14:50:03, bërë mes të pandehurit Saimir Sulejmani nëpërmjet numrit celular 0697498051 dhe të pandehurit Esat Mehmetit nëpërmjet numrit celular 0695764588, si më poshtë:
*“051: alo, 588: alo përshëndetje, 051: alo, 588:alo, 051: po, 588:0 Çakja jam unë, 05l:po, 588: dua të takoi një çikë, 051:sjam, jam një çikë larg, 588:je larg po mirë a ke vajt dikund në Lezhë, kam lenë kockat, dhe ke marrë ca gjëra...051: po, 588: (nuk kuptohet) të tual janë kto, 051:eee, 588: (nuk kuptohet), 051:ke, 588:ke marrë ca gjëra aty në Lezh, 051 :jo në Lezhë jo, në shijak, 588: në Shijak...problem, 051: epo kam marrë ca gjëra unë dhe se mohoi atë pjes, 588:si, 051: po ngjo një çikë se nuk e merr vesh. Sikur mora nja dy...te ai shoku Marselo, po ti se ke vënë ujin në zjarrfare ti.., 588: ca re..051: kam marrë nja dy të mira unë, 588: dy të mijë!, 051: unë e unë të mirë, 30 dhe 10 kam marrë 40 ijë euro, 588:i ke marrë, i ke kthyer mbrapa ti ato Baftjarit, 051: jo mo shok jo se 18 kam kthy mbrapa unë, 588: i ke kthyer mbrapa, po s’ke marrë dy ti, 20 ke marrë, 051: jo mo shok jo se 18 kam kthy mbrapa unë, 588: i ke kthyer mbrapa, po s’ke marrë dy ti, 20 ke marrë, 051: po jo ore zotëri, llogarinë tëndë, ngjo se nuk është herë e parë që ti bën këto,po..588: si kam bërë fare unë...051: i bën me Malon, i bën me të tërë, ngjo mua tani.., 588: cilin Malo o vëlla?..nuk kuptohet, Mlaos i ke lekë borgj.,051: lekët ia dhashë Malos o zotëri, po e bëre ti këtë pjes!, 588:jo e bërë ti, nuk e bëra unë..051: ngjo mua ti, ia bën vet, nuk ia bën Mirit atë punë, se Miri po rri në heshtje, po rri pasiv shumë, 588: ca po rr pasiv ti!, 051: po rri shumë pasi, ngjo një sekond, ti gjithmonë zotëri thua. Por i kam marrë 40 mijë euro atij shokut, jo 40, por i bie 48, ..588:ore ti mund ti marrësh edhe 100, është halli jot...051 :jo mo jo, si kam marë, i kam marrë për llogarinë lonë, jo timen se ti ke pjesën...588:ore ske marrë për llogari timen fare, fare, 051: më duket se 10 me 30-shen e kemi marrë bashkë..588:po,po, i ke kthyer mbrapa, i more andej lart...051 :dhe 3 mijë euro i Kam marrë për ty, laj borgjet e tua unë...588:hajde dhe bëjmë nga afër këto muhabete...051: po unë i bëj, i kam bërë dhe i bëj prap se nuk është problem fare.. 588: ske ardh fare o zotëri...051: po i harron ti këto pjes, po ti ke ardh i përgatit, po je ti, të thashë bëj llogaritë e<sub>r</sub> atherë më thirr mua, 588: jo ore, i kam bërë shumë mirë llogaritë unë, 051: bëj llogaritë shumë bukur e ti bësh prapë llogaritë, 588: ti bëj llogaritë prapë eee?, 051: po bëj prap llogaritë e të jesh në rregull, 588: po të them se e ke gabim!, 051: hajde, 588: jo nuk e kam gabim unë, e ke ti gabim që i bën këto sjellje me mua një herë, po duhet ta dish një diçka, ngjo mua, ti me malon edhe këtë që ma thua mua e ke bërë vetë e sma bën Miri...051: ore lej këto muhabete... 588: jo ore leje këlo muhabete, jo ore...051: këto muhabete lëri se nuk është mirë për ty një herë...588: lëre ore ti, është mirë, nuk është mirë, hajde këtu vëlla ose vij unë aty ku je ti e takohemi...051 :po ja, jam i zënë o zotëri, kur të jem unë i lirë, takohem ne dhe bëj llogaritë.,588: mua më thua kur je i lirëe unë po të pres, në rregull..051: ore unë nga nesër e lutje i lire jam, ore..588: rtë rregull do vij, më bëj një zile mua dhe atje më ke..051: edhe bëj edhe një herë llogaritë të thashë dhe i bëjmëprapë, 588: ore i kam bërë llogaritë..051: hajt”.*

**Në momentin e arrestimit, të pandehurit East Mehmeti i është sekuestruar sasia e lëndës narkotike prej 0.894 gr e llojit kokainë. Në bazë të aktit të ekspertimit kimik nr. 13494, datë 31.12.2018 ka rezultuar se nga analiza me GC/MS, për pluhurin objekt ekspertimi, tregoi për praninë e kokainës. Në bazë të aktit toksikologjik nr. 2657, datë 02.11.2018, ka rezultuar se në mostrën urinare të marrë shtetasit Esat Mehmeti, nuk u zbulua prania e produkteve të mctabolizmit të kokainës në organizmin e njeriut.**

[shqiptarja.com]

Nga ndjekja e metodave speciale të hetimit në vijim kanë rezultuar të dhëna për ushtrimin e aktivitetit kriminal të të pandehurit Astrit Balliu(Avdyli) me anëtarët e tjerë të grupit kriminal në fushën e narkotikëve.
*Kështu sipas transkriplimit të përgjimit të bisedave të përgjuara të shtetasit Altin Avdyli, rezullon se me datë 30.05.2018 nëpërmjet numrit të tij + 765, i ka dërguar sms personit tjetër në numrin +314, duke i e informuar se ai miku kryesor atje larg është dhe miku im. Jamë këtu me këtë po ua klheve, jam unë garantë, po se ktheve me mua dhe mikun tim do keshë punë, mendoje gjonat mirë...Astriti jam; komunikimet vijonë lidhur me një problem që iu ka dalë, ku personi tjetër bën me dije Astritin duke i thënë se ata ishin miq, i kërkonte të mos i hynte në atë punë, pasi ai lekët e veta kishte marrë, dhe problemin e kishte me ata nga Rinasi; ndërkohë që Astriti dhe Altini bëjnë me dije personin në jjalë se miqtë nga Rinasi ishin edhe miqtë e tij; komunikimet në vijim janë ndërmjet numrave sa më lartë lidhur me problemin që iu ka lindur ndërmjet tyre, ku duket se personal në jjalë flasin në mënyrë të koduar, për prishje në "pazaret " e lëndës narkotike.*
**Me datë 21.10.2018, gjatë vëzhgimit të të lëvizjeve të të pandehurit Astrit Balliu alias Avdyli, në vendin e quajtur lokali i shtetasit Sabri Smoqi, në fshatin Kënet, Shijak, është konstatuar se shtetasi Astrit Balliu alias Avdyli ka nxjerrë nga çanta e tij që mbante me vete armën pistoletë me mbishkrimin "ËALTER-P.P.Q-Made in Germany, me numër FAY3173, së bashku me një krehër me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fishekë. Arma pistoletë së bashku me municionin janë sekuestruar me cilësinë e provës materiale.** Në bazë të aktit të ekspertimit teknik Nr. 12056, datë 14.11.2018, ka rezultuar se kjo armë është teknikisht e rregullt.
**Sipas raportit Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të kryer me date 11.02.2018, ka rezultuar:**
**Ora** 13:50, Konstatohen përpara restorantit "Detari i Vjetër" autornjeti BMË ngjyrë e zezë, me targa AA 808 **RH,** i cili përdoret nga shtetasi **Xhevahir** dhe disa automjete te tjera, Benz ngjyra e zezë me targa AA 900 **TD,** autornjeti BMË X6, ngjyrë e zezë, me targa AA 100 **SX,** autornjeti Benz C Klas, ngjyrë gri, me targa AA 639 **SM.**
**Ora 14:17,** Konstatohet duke dalë nga restorant "Detari i Vjetër" një person rreth moshës 33 vjeç me flokë të zeza pak të rëna para, i veshur me një xhup të zi me kapuç, dhe pantallona xhinse blu i cili afrohet tek autornjeti me targa **AA 808 RH** hap derën dhe mer diçka dhe futet përsëri në ambientet e brëndëshme të restorant "Detari i Vjetër".
**Ora 15:20,** Konstatohen nga ana jonë duke dalë nga restorant "Detari i Vjetër", personi rreth moshës 33 vjeç bashkë me të, dal in dhe dy persona të tjerë, ku **personi i parë** rreth moshës 39 vjeç, me flokë të zeza, i veshur me një kostum sportiv ngjyrë e zezë, **personi i dytë** rreth moshës 18 vjeç, me flokë gëzhtenj, i veshur me një xhup ngjyra e zezë me kupuç, dhe pantallona xhinse blu. Në këtë moment del dhe një person rreth moshës 41 vjeç me flokë të zeza, i veshur me një pardesy ngjyrë e zezë dhe pantallona të zeza, të cilët bisedojnë në këmbë me njëri- tjetrin.

**Ora 15:26,** Nga restorant "Detari i Vjetër" dalin shtetasi **Astrit** me tre persona, **personi i pare** rreth moshës 55 vjeç, me flokë të thinjura, i veshur me një xhup ngjyra e zezë me kapuç, **personi i dytë** rreth moshës, 38 vjeç me flokë të zeza qethura shkurt, i veshur me një kostum sportiv, ngjyrë blu me të zezë, **personi i tretë** rreth moshës 40 vjeç, me flokë të zeza, i veshur me një kostum sportiv dhe xhup, ngjyrë e zeë me vishnje, në krah kishte një çantë dore ngjyra e zezë, të cilët bashkohen me shtetasit rreth moshave 33 vjeç, 39 vjeç, 18 vjeç, 41 vjeç, 36 vjeç, 37 vjeç, shtetasi Arben Ndoka dhe Xhevahir.
**Ora 15:30,** Tek automjeti me targa **AA 808 RH** hipën si drejtues shtetasi **Xhevahir** dhe pasagjer në vendin e parë shtetasi **Astrit,** në automjetin me targa **AA 100 SX** hipën si drejtues personi rreth moshës 36 vjeç dhe pasagjer në vendin e parë personi rreth moshës 18 vjeç, në automjetin me targa **AA 639 SM** hipën si drejtues personi rreth moshës 40 vjeç, pasagjer në vendin e parë personi rreth rnoshës 38 vjeç dhe pasagjer në vendin mbrapa personi rreth 55 vjeç dhe të tre automjetet vazhdojnë lëvizjen njëra pas tjetrës në bulevardin "Nën Tereza", në rrugën nacionale Shëngjin - Lezhë, në rrugën "Gjergj Fishta" automjeti me targa **AA 808 RH** ndalon për rreth një minuti dhe përshëndeten me dy persona, **personi i parë** rreth moshës 32 vjeç, me flokë të qethura zero, i veshur me një xhup kafe dhe xhinse të zeza, **personi i dytë** rreth 31 vjeç, me flokë të zeza të qethura shkurt, i veshur me një xhup ngjyra e zezë dhe xhinse blu, të cilet po qendronin në këmbë dhe inë pas parkohen të tre automjetet

[shqiptarja.com]

përpara një ndertese 4 katëshe ngjyrë e kuqe me xhama blu. Personi rreth moshës 37 vjeç futet përsëri në ambientet e brëndëshme të restorant "Detari i Vjetër".
**Ora 16:03,** Nga ndërtesa katër katëshe me ngjyrë të kuqe dhe xhama blu dalin shtetasi **Astrit** dhe personat rreth moshave moshës 55 vjeç, 40 vjeç, 38 vjeç, 36 vjeç, ku personi rreth moshës 40 vjeç hipën si drejtues në automjetin me targa **AA 639 SM,** personi rreth moshës 38 vjeç hipën si pasagjer në vendin e parë, kurse personi rreth moshës 55 vjeç hipën si pasagjer në vendin mbrapa. Shtetasi **Xhevahir** hipën në automjetin me targa **AA 808 RH** si pasagjer në vendin e parë dhe drejtues personi rreth moshës 18 vjeç. Tek automjeti me targa **AA 100 SX** hipën si drejtues personi rreth moshës 36 vjeç. Në këtë moment tek shtetasi **Astrit** afrohet një person rreth moshës 28 vjeç, me flokë të zeza, i veshur me një xhup ngjyra vishnje dhe tuta të zeza, i cili bisedon përreth një minutë ndahen nga njëri-tjetri ku, personi rreth moshës 28 vjeç vazhdon lëvizjen në këmbë në shëtitoren "Gjergj Fishta", kurse shtetasi **Astrit** hipën si pasagjer në vendin mbrapa të automjetit me targa **AA 639 SM.**
**Nga vëzhgimi i lëvizjeve të të pandehurit Astrit Balliu, sipas procesverbalit të datës 03.06.2018 ka rezultuar se:**
**Ora 15:45,** Konstatohen të ulur në ambientet e jashtme të bar "Apokalips" shtetasi **Astrit Balliu (Avdyli), Xhevahir Ndoka** dhe dy persona të tjerë të paidentifikuar. Në këmbë qendronin shtetasi **Fatos Llaftiu** me personat rreth moshave 40 vjeç dhe 36 vjeç qe lëvizin me shtetasin **Astrit Balliu (Avdyli).** Të parkuara përballë Bar "Apokalipsi" ishin automjetet e tipit, Audi, ngjyrë e zezë me targë **AA 521 UA,** automjeti i tipit Mercedes Benz, ngjyrë e zezë, me targa **AA 893 TT,** automjeti i tipit Mercedes Benz, ngjyrë gri me targa **AA 639 SM,** automjcti Mercedes Benz, ngjyrë blu, me targa **AA 688 TP,** automjeti i tipit Ford, ngjyrë gri, me targa **AA 211 DY,** automjeti i tipit Audi, ngjyrë gri me targa me targa **AA 698 DX.** Konstatohet automjeti i tipit BMV, ngjyrë blu me xhama të zinj mbrapa, me targa **AA 799 HD,** me dy persona, personi i parë, drejtuesi i automjetit një person rreth moshës 36 vjeç, me flokë të zeza, i veshur me një bluzë me ngjyrë të zezë, me tatuazhe në të dyja duart, personi i dytë, pasagjer rreth moshës 22 vjeç, me flokë të prera shkurt, të zeza, i veshur me një bluzë me ngjyrë të bardhë, të cilët po kontrollonin me automjet duke lëvizur pranë bar "Apokalips".

**Sipas raportit mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve, të kryer me datë 04.06.2018, ka rezultuar:**
**Ora 20:28,** Konstatohen në ambientet e jashtme të Spitalit Ushtarak shtetasi **Astrit Balliu (Avdyli)** dhe shtetasi **Arniand Spiro** duke biseduar me njëri-tjetrin. Rreth 5 metra më larg konstatohet shtetasi **Xhevahir Ndoka** duke biseduar me një person rreth moshës 44 vjeç, qeros, i veshur me një këmishë ngjyrë blu dhe xhinse blu.
**Ora 20:52,**Në automjetin Audi ngjyrë e zezë me targa **AA 521 UA** *(i njëjti automjet që ishte i parkuar tek Bar kafe Apokalips më datë 03.06.2018 në qytetin e Lezhës)* drejtuesi nuk u identifikua për arsye të pamjes kufizuar, doli nga Spitali Ushtarak dhe vazhdoi lëvizjen në rrugën "Lord Bajron".
**Sipas procesverbalit Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të kryer me datë 08.10.2018, ka rezultuar se:**
**Ora 13:35,** Konstatohet në lëvizje në rrugën ''Muhamed Gjollesha" në këmbë shtetasi Armand Spiro i cili vazhdon lëvizjen në rrugën "Sandër Prosi" dhe ulet në ambientet e jashtëme te bar kafe "Talis"në një tavolinë ku ishin të ulur shtetasit **Astrit Avdyli** dhe dy persona, **personi i parë** rreth moshës 35 vjeç, qeros, i veshur me një bluze ngjyra blu e errët, dhe pantallona xhinsë ngjyra blu, **personi i dytë** rreth moshës 33 vjeç, më flokë të zeza me mjëkër më syze djelli, i veshur me një bluze ngjyrë e zezë, dhe pantallona xhinse ngjyra blu, gjithashtu i ulur në një tavolinë në vëte shtetasi **Fatos Llaftiu.**
**Ora 14:05,** Nga Bar Kafe "Talis" dalin shtetasit **Armand Spiro, Astrit Avdyli, Fatos Llaftiu** dhe personat rreth moshave 33 vjeç, 35 vjeç. Pasi përshëndeten me njëri- tjetrin, shtetasi Armand Spiro vazhdoi lëvizjen në këmbë në rrugën "Sandër Prosi", në rrugën "Muhamed Gjollesha", ndërsa shtetasi **Fatos Llaftiu** hipën si drejtues në automjetin e tipit Volsvagen ngjyra gri me targë **AA** 651 SZ, pasagjer në vendin e parë shtetasi **Astrit Avdyli,** pasagjer mbrapa personi rreth moshës 35 vjeç dhe vazhdojnë lëvizjen në rrugën "Sandër Prosi".
*Me datë 15.03.2017, Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore Gjirokastër, kanë arrestuar në Jlagrancë shtetasin Përparim Voda ( alias Sulka), i cili kishte në përdorim karlë identiteti greke me gjeneralitete të falsifikuara (emër tjetër me fotografinë e tij në të). Gjithashtu, rezultoi se ky shtetas ishte person i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Autoritetet Italiane të*

[shqiptarja.com]

*Drejtësisë për veprat penale lë shfrytëzimit të prostitucionit dhe të pjesëmarrjes në organizatë kriminale.*
Nga Iranskriptimi i përgjimit kanë rezultuar të dhëna se me datë 04.03.2017, personi nën kërkim Përparim Voda ( alias Sulka), nga numri i tij celular grek 00306942563877 ka bërë bisedë telefonike me të pandehurin Saimir Sulejmani(alias Mir Sulejmani), i cili ka përdorur numrin celular 0685845828, me të cilin kanë shkëmbyer sms dhe kanë lënë vende takimi. Në këto kushte ka vijuar mbajtja nën vëzhgim nga Forcat Operacionale, të cilat më pas në koordinim me Policinë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore Gjirokastër, realizuan arrestimin e personit në kërkim Përparim Voda (alias Sulka).
Nga aktet e administruara rezulton se janë kryer hetime me metoda speciale të hetimit edhe ndaj veprimtarisë së kundraligjshme të shtetasve Vilson Ndoka dhe Danjan Ndoka. Rezulton se në këtë periudhë janë mbajtur në përgjim numrat celualr 0684368193, në përdorim të shtetasit Vilson Ndoka, si dhe numri celular 0693816454, që përdorej nga shtetasi Danjan Ndoka.
Personat në fjalë ka rezultuar të ishin në ndjekje të Policisë Vendore Lezhë për vepra penale të tjera, ku gjatë kohës që po kërkohej për arrestimin e tyre, me datë 28.05.2017, nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore Lezhë, është bërë arrestimi në flagarancë i shtetasve Ndue Frroku, Fatjon Marku, Gentjan Noka. Kjo pasi ka rezultuar se këto shtetas mbanin me vete në ambiente publike dhe në banesa të tyre sende të kundraligjshme, si radio komunikimi të ngjashme me ato të policisë, një sasi municioni, makineta, kompjutera që shërbejnë për lojra fati, automjet të blinduar. Personat në ljalë janë proceduar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë për veprat penale të kryera prej tyre.
Nga hetimi ka rezultuar se pjesëtarët e këtij grupi kriminal, ndërkohë që kishin si aktivitet kriminal kryesor trafikimin e lëndëve narkotike, ato merreshin edhe me shitjen dhe shpërndarjen e saj në "tregun" e brendshëm tek bashkëpunëtorët e tyre. Kështu, rezulton se i pandehuri Altin Avdyli, rezulton t'i ketë "dhënë" lëndë narkotike kokainë disa personave, ndër ta shtetasit Elton Gjini.
**Me datë 16.06.2018, Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore Lezhë kanë bërë arrestimin në flagrancë të shtetasit Elton Gjini, pasi ka rezultuar se gjatë kohës që ai po lëvizte me automjetin e tij të markës BMË, ngjyrë blu, me targa HTS1336, nga qyteti i Laçit në drejtim të Lezhës, i është gjetur dhe sekuestruar sasia e lëndës narkotike prej 46.67 gram të llojit kokainë.**
Në bazë të aktit të ekspertimit kimik nr.8527, datë 07.08.2017, ka rezultuar se analiza me GC/Mc, për pluhurin objekt ekspertimi, tregoi për praninë e kokainës.
Nga transkriptimi i përgjimeve telefonike të bëra me datë 16.06.2017, ora 13:28, nga i pandehuri Altin Avdyli, i cili përdor numrin celular 0698967765 dhe shtetasit Elton Gjini, i cili ka përdorur numrin celular, 0696752599, kanë rezultuar këto të dhëna me përmbajtje bisede si më poshtë:
" *-Kur mund të kaloj me pi noj kafe te hoteli.* "
Nga transkriptimi i bisedave të përgjuara me datë 16.06.2017, ora 13:30, ndërmjet i pandehuri Altin Avdyli, i cili përdor numrin celular 0698967765 dhe shtetasit Elton Gjini, i cili ka përdorur numrin celular, 0696752599, kanë rezultuar këto të dhëna me përmbajtje bisede si më poshtë:
" *Gjergji jam. / A ta bë një telefon a ma bën, po ta bëj një telefon për pak sa ta takoj atëshokun edhe të visit.../O Gjergji, hajde mbasdite".*
Në po të njëtën datë, në orën 17:55, mes personave të mësipërm janë bërë këto biseda telefonike:
*"A të kaloj nga hoteli apo të kaloj nga lagja. në orën 17:57 " A je në Shijak. /-po /-pi kafe ku të duash se erdha. në orën 18:37* **"** *Hë Gjergj, ku je vë/Ia. /ja këtu te hyrja. /kelu jam me makinë duke ardhë drejt teje nga shtëpia andej /aty jam unë me një BMË BLU. /nuk të pash, unë ty o vëlla. /hajt se po hyj te rrugica*
Nga transkriptimi i përgjimit të bisedave mes të pandehurit Altin Avdyli nëpërmjet numrit të tij 0698967765 me personin që përdor numrin celular,me datë 26.03.2017, ora 16:52:14, kanë rezultuar këto biseda si më poshtë:
*"765: hë Jeta, 812.Nice shif ktu ja, 400 mijë lekshin llogarite 300 euro, pa 5 mijë lekë, ...300 dhe 100 i ka ia, i bie 400 euro për 32 i bie 12.5 gram, 765; hajt, 812: se 10 gram i bie 320, 765: po, hajt, 812: ee, kështu që jepi 12.5 gramë, dhe ja mban 5mijë lekshin herës tjetër, 765: hajt, 812; 12.5, hajt".*
**Sipas transkriptimit të përgjimeve ndërmjet të pandehurit Altin Avdyli nëpërmjet numrit 06989967765 me personin me numrin 0693936608, datë 26.04.2018, ora 19:32:15, ndër të tjera**

[shqiptaria.com]

**rezulton** *se:+765:Po/+608:Haaa..mirë duket a?/... + 765:...duhet me ik me lëviz që aty, mos rri mo, ik, ik andej ka shpia, mos lëviz...morri ai shoku/+608Ahhh?+765:Turi...mori ai miku jonë, do dal me atë në xhiro kalecat tashi, do vinë të Tiranës/+608:Ku ven? Në zonë tonë apo aty/+765:Knej në zonë tonë edhe anej...vërdall edhe këtu.../+608:Aha...unë në shpi jam tu ik/+765:...Eh se më lajmëroj ai, më shkrujti...*

**Nga procesverbali mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të kryer me datë 27.06.2018, ka rezultuar se:**

**Ora 12:20,** Konstatohet në hyrje të qytetit të Fierit në Mbrostar automjeti tip Toyota, ngjyrë gri, me targa **AA 953 SZ,** me drejtues shtetasin **Altin Avdyli (Niçja),** pasagjer në vëndin e parë shtetasin **Fatos Llaftiu** dhe një person tjetër pasagjer mbrapa, rreth moshës 50 vjeç, me flokë të thinjura, i veshur me një këmishë ngjyrë blu dhe pantallona të zeza, ku ndalojnë te një byrektore ne zonën e Mbrostarit, ku të tre personat zbresin nga automjeti dhe futen në ambjentet e brëndshme të byrektores.

**Ora 12.30'** Shetasi **Altin Avdyli (Njçja),** shtetasi **Fatos Llaftiu** dhe personi rreth moshës 50 vjeç dalin nga ambjentet e brëndëshme të byektores dhe hipin në automjetin me targa **AA 953 SZ** dhe vazhdojnë lëvizjen drejt qytetit të fierit në rrugën "Jakov Xoxa" në rrugën "Dërvish Herkali" në rrugën "Brigada XI Sulmuese" në rrugën e "Semanit" ku ndalon dhe parkon automjetin te një karburant "GRAND PETROL" dhe zbresin të tre personat dhe futen brënda ambjenteve të bëndshme të bar kafe "GRAND PETROL" para bar kafes ishte i parkuar automjeti tip Audi, me ngjyrë të zezë më targa **AA 041 OZ** dhe një automjet tip Ford Mustang ngjyrë e zezë pa targa.

**Ora 13.25,** Konstatohet automjeti me targa **AA 953 SZ** duke lëvizur në rrugën e "Semanit" me drejtues shtetasin **Altin Avdyli (Niçja),** pasagjer në vëndin e parë shtetasin **Fatos Llaftiu** dhe mbrapa personi rreth moshës 50 vjeç dhe lëvizin në rrugën "Brigada e XI Sulmuese" në rrugën "Dërvish Herkali" në rrugën "Jakov Xoxa" rrethrrotullimi i "Sheqit" dhe në rrugën nacionale Fier - Lushnje - Durrës.

*Me date 16.06.2018, nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore Durrës, është ushtruar kontroll tek banesa e personit nën hetim Saimir Gjepali, ku janë gjetur dhe sekuestruar me cilësinë e provës materiale, një sasi prej 149 gram lëndë narkotike e llojit kokainë, një peshore elektronike, dy armë automatik, një armë pistoletë, një armë gjahu, një pistoletë sportive, një sasi municioni, dhe një automjet i blinduar.*

Nga metodat speciale të hetimit,nga përgjimi i bisedave të të pandehurit, Saimir Gjepali që bën me familjarët e tij, ai i udhëzon që të hedhin lëndën narkotike dhe pistoletën që ai i mbante në banesën e tij, duke iu thënë që të mos e hapnin derën e dhomës ku ndodheshin këto sende. Konkretisht me **datë 16.06.2017,** familjari i të pandehurit Saimir Gjepali, nëpërmjet numrit që ka përdorur 697738950, ka telefonuar të pandehurin Gjepali tek numri i këtij të fundit 355697559098, me përmbajtje si më poshtë:

*"+950: Hë Shaqe! +098: Alo!+950:Ka ardh policia kontroll ke sh 'pia e re,janë t 'u e hap derën e sh'pisë së re, +098: Ç'a thu ti ere?, +950:Ç'a bë bëj?, +098: Mos ia hap, mos ia hap, mos e hap, +950: Jo! Ç'a t'i them, ç'a t'i them?, +098: S'kam! E ka burri çelësin thuj, a n'gjon?!, +950: Po, po! Ejj, mos bëjnë kontroll këtu?, + 098: Ku ri?, +950: Këtu ke sh'pija jonë, +098: Mos e hap, derën fare Nila. Hajtl, +950: Ke sh'pija jonë që jena këtu, +098: Kush është aty, kush është? Ç'a policie është?, +950: Janë një tufë me maska, dy fugona, +098: Ç 'a thu ti ere?!!! Hajt, +950: Ç'a të bëj këtu ke sh'pia jonë, ç'a të bëj kë sh'pija jonë?, +098: Si?, +950: Ç'a të bëj këtu ke sh'pia jonë?, +098: S'ke ç'a me bo asgjë Nila, mbyll derën e dhomës aty përjasht, merr ke një pistoletë atje sipër asaj..., +950: Ku, ku, ku?, +098:...sipër minibarit, kape hudhe andej nga Striu, hë, +950: Ku, ku, ku?, +098: Sipër minibarit, hudhe nga Siriu, hë, hajt!, + 950: Po, po, +098: Hajt* **".**

Me **datë 16.06.2017,** i pandehurit Saimir Gjepali, nëpërmjet numrit që ka përdorur 355697559098, ka telefonuar familjarin e tij tek numri 697738950, me përmbajtje si më poshtë:

*"098: O Nila, 950: thuje, jetoje atje, nuk jetoj këlu, 098: ku, 950: të mos vijnë për kontroll, 098: hudh vetëm pistoletën, 950: e hudha, 098: mos e hap derën e barakes atje se kedy kallashe, hidhi matanë, a dëgjon ti, 950: po, 098:hodhi mas pulave..ke dy kallashe atje, 950: he, 098: ke dy kallashe atje tek dhoma, sipër këpucëve, hodhi matanë tek...dhe hapi shtëpinë e vjetër, nuk jetoj më atje ...jetoj më këtu. 950:mirë, hajt, 098: a dëgjon, 950: po më pyetën për ty, çfarë tu themë.,098: zotria ka kikur deri në Lushnjë..vetëm hedhi dy kallashët, mos e hap shtëpinë e re, as garazhe, asgjë...950: mirë, mirë, 098: futi tek shtëpia e vjetër...hudhidy kallashët matanë tek shtëpia e....".*

[shqiptarja.com]

Biseda e datës 16.06.2017, ora 21:31:41 mes familjarit të pandehurit Saimir Gjepali që përdor numrin e telefonit 355697559098 dhe personit tjetër me numër celulari 0697559098:
*"098: ku je ti, 880: në Pazar, 098: shko thuje si ështëpuna, më kupton...880: ok, 098: edhe këtë, edhe atë, thuaj ëshlë shtëpia ime,janë të miat...ike vetë, 880:në rregull, ok, 098: hajte, cao* **".**
Nga përmbajtja e këtij përgjimi në harmoni me aktet e administruara rezulton se me datë 16.06.2017,nga ana e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore është ushtruar kontroll tek banesa e shtetasit Saimir Gjepali në lagjen ballias Shijak, ku gjatë kontrollit, në katin e parë është gjetur dhe sekuestruar një kavanoz qelqi me kapak metalik, në të cilën gjendeshin një peshore elektronike lendë narkotike, tre qese plasmasi të lidhura, në të cilën ndodheshin 149 gr lëndë narkotike kokainë. Gjithashtu gjatë kontrollit të banesës së personit nën hetim Saimir Gjepali, janë gjetur dhe sekuestruar dy armë zjari automatike model 56, dy armë zjarri pistoletë, një armë gjahu, si dhe një sasi municioni luftarak për armët e zjarrit dhe për armët e gjahut, të cilët sipas aktit të ekspertimit teknik nr. 8422, datë 03.08.2017, kanë rezultuar se janë në gjendje të rregullt teknike. Nga akti i ekspertimit kimik nr. 8575, datë 07.08.2017, ka rezultuar se analiza me GC/MS për pluhurat objekt ekspertimi treguan për praninë e kokainës. Analiza me GC/MS, për mbejtjet në peshoren elektronike, tregoi për praninë e kokainës.

Nga përgjimet telefonike rezulton se lënda narkotike dhe armët e zjarrit të sekuestruara në banesën e të pandehurit Saimir Gjepali, janë të të pandehurit Saimir Gjepali,pavarësisht faktit se për këtë fakt penal është akuzuar edhe vëllai i tij, Emiljano Gjepali.
**Me datë 08.07.2018, nga vëzhginii i të pandehurit Petro Kuçi(alias Abedin Kuçi), i cili po lëvizte me mjetin e tij tip Volvo, me targa AA 301RJ nga Tirana në Gjirokastër, me pasagjer shtetasin Bledar Sinojmeri, gjatë kontrollit këtij të fundit i është gjetur sasia e lëndës narkotike prej 08 g. llojit kokainë.**
Nga aktet e administruara ka rezultuar se me datë 08.07.2018 i pandehuri Petro Kuçi(alias Abedin Kuçi), posedues i disa numrave celular, ndër ta edhe numrin 0698390909, së bashku me shtetasit Bledar Sinojmeri, posedues i numrit celular 0695436551 dhe Merjeme Sinojmeri, kanë ardhur në Tiranë, ku janë takuar me subjektin nën hetim, shtetasin Hajri Seferi tek Hotel "Real Park" në autostradën Durrës - Tiranë, në Kashar. I pandehuri Petro Kuçi(alias Abedin Kuçi), rezulton se ka qëndruar disa orë në ambientet e këtij hoteli së bashku me personat e mësipërm, ku në një moment kanë vijuar takimin e tyre mbrapa hotelit dhe më pas janë nisur për në Sarandë. Një fakt i tillë është i dokumentuar nga raportef e vëzhgimit të Forcave Operacionale të datës 08.07.2018, ku janë pasqyruar lëvizjet nga momenti që i pandehuri Petro Kuçi(alias Abedin Kuçi) ka mbrritur në Tiranë deri në momentin kur është larguar. Më pas, në kthim të këtij personi nga Tirana, është organizuar nga policia kontrolli i tyre ku rezulton të jetë sekuestruar sasia e lëndë narkotike e llojit kokainë e përcaktuar më sipër.
**Nga procesverbali Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të kryer me datë 01.07.2018, ka rezultuar se:**
*Or a 17:50, Konst atohet automjeti tip Volvo, me ngjyrë gri me targa AA 408 SS me drejtues shtetasin Hajri Seferi dhe pasagjer në vëndin e parë një person rreth moshës 16 vjeç me flokë të zeza dhe syze opt ike duke lëvizur në rrugën nacionale Tepelenë - Memaliaj - Fier.*
*Ora 17:55, Pas komunikimit me drejluesin e operacionit grupi vëzhgimit niset për në qytetin e Delvinës konkretishl në fshatin Siar për konstatimin e shtetasit Petro (Abedin) Kuçi dhe automjetin tip volvo me ngjyrë të bardhë me targë AA 301 RJ.*
*Or a 19:16, Konstatohet në fshatin Siar i parkuar perballë shtëpisë tre katëshe me ngjyrë gri automjeti tip volvo ngjyrë të bardhë me targë AA 301 RJ.*
*Ora 19:46, Konstatohet automjeti Volvo, me targa AA 408 SS, me drejtues mjeti shtetasin Hajri Seferi dhe pasagjes në vëndin e parë personi rreth moshës 16 vjeç dukë lëvizur drejtim të qytetit Durrësit.*
*Ora 20:10, Automjeti me targa AA 408 SS me drejtues shtetasin Hajri Seferi dhe personin rreth moshës 16 vjeç futet për në qytetin e Shijakut.*
**Nga procesverbali Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të kryer nga data, me datë 05.07.2018, ka rezultuar se:**

[shqiptarja.com]

*Ora 11:20, Konstatohet eparkuar tek karburant "Daku OH", automjeti i tipit Volvo ngjyra gri me largë AA 408 SS.*
*Ora 11:40, Konstatohen tek bar kafe tek karburant "Baku OH" shtetasit Hajri Seferi, Drini bashkë më një person rreth moshës 43 vjeç, meflokë të zeza të prera shkurt, i veshur me një bluze ngjyra e bardhë, dhe pantallona të shkurlëra ngjyra jeshile. Në këtë moment shteiasi Hajri Seferi ndahet nga shletasi Drini dhe personi rreth moshës 42 vjeç dhe hipën në automjetin me targë AA 408 SS dhe vazhdon lëvizjen në rrugën nacionale Tiranë - Durrës ku nuk mbahet në vëzhgim nga ana jonë. Ndërsa shtetasi Elton (Drini) bashkë me personin rreth moshës 43 vjeç hipin në automjetin e parkuar të tipit Ford Fokus ngjyra gri me targë AA 961 DG dhe vazhdojnë lëvizjen në drejtim të qytetit të Tiranës.*
**Sipas procesverbal Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të kryer me datë 06.07.2018, ka rezultuar se:**
*Ora 12:25, Konstatohet duke dalë nga bari i karburant "Daku Oil " shtetasi Hajri Seferi bashkë me shtetasin Elton (Drini) dhe një person rreth moshës 44 vjeç, qeros, i shëndoshë, i veshur me një bluze ngjyra gri dhe tut a të zeza, ku pasi ndahen nga njëri tjetri shtetasi Hajri Seferi hipën si drejtues në një automjet të tipit Audi ngjyra gri me targë AA 294 OI, dhe vazhdoi lëvizjen në drejtim të Vorës, ndërsa shtetasi Elton (Drini). bashkë me personin rreth moshës 44 vjeç, hipin në një automjet të tipit Benz, ngjyra e zezë me targë AA 221 TZ si drejtues personi rreth moshës 44 vjeç dhe vazhdojnë lëvizjen në rrugën nacionale Vorë* **-** *Tiranë, në rrugën "Dritan Hoxha", në rrugën Teodor Keko", në rrugën e "Kavajës", në rrugën "Muhamed Gjollesha* **",** *në rrugën "Myslym Shyri* **".**
*Ora 12:52, Automjeti me targë AA 221 TZ ndalon në rrugën "Myslym Shyri", parkon automjetin zbresin shtetasi Elton (Drini) bashkë me personin rreth moshës 44 vjeç dhe futen tek bar "Momo". Ora 13:22, Personi rreth moshës 44 vjeç ndahet nga shtetasi Elton (Drini) hipën si drejtues në automjetin me targe AA 221 TZ dhe vazhdon lëvizjen në rrugën "Myslym Shyri ", në rrugën "Sami Frashëri", në rrugën "Liqeni i Thatë".*
**Procesverbal Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të kryer me datë 08.07.2018, ka rezultuar se:**
*Or a 08:30, Konstatohet në lëvizje në rrugën nacionale Kavajë - Durrës konkretisht pranë mbikalimit të Shkozetit, automjeti i tipit Volvo ngjyra e bardhë me targë AA 301 RJ me drejtues shtetasin Petro (Abedin) Kuçi, pasagjer në vendin para një person i gjinisë femërore rreth moshës 34 vjeç, me flokë të zeza dhe bluze të bardhë, pasagjer në vendin mbrapa një person i gjinisë femërore rreth moshës 12 vjeç, me flokë të zeza, dhe vazhdoi lëvizjen në rrugën nacionale Durrës - Tiranë, ku tëk mbikalimi i Kasharit kthehel djathtas dhe vazhdon lëvizjen në rrugën dytësore "Industrial* **",** *në rrugën "Dardaniq* **".**
*Ora 08:52, Automjeti me targë AA 301 RJ ndalon dhe parkohet tek hotel "Real Park", zbresin shtetasi Petro (Abedin) Kuçi personal e gjinisë femërore rreth moshës 34 vjeçe dhe 12 vjeçe dhe futen në ambientet e brëndshme të hotelit.*
*Ora 09:20, Shtetasi Petro (Abedin) Kuçi del nga ambientet e hotel "Real Park " hipën në automjetin me largë AA 301 RJ dhe vazhdon lëvizjen dhe ndalon tek bar kafe pa emër ngjitur me mobilieri "Hendi* **",** *zbret nga automjeti dhe takon dy persona (në dukje puntorë ndërtimi), personi i parë rreth moshës 55 vjeç, me kapele në kokë, i veshur me pantallona të shkurtëra bezhë, personi i dytë rreth moshës 49 vjeç, me flokë të zeza, i veshur me pantallona të zeza lë shkurtëra të cilët po punonin në një lokal ngjitur dhe futen tek lokali pa emër ngjitur me mobilieri* **"***Hendi".*

*Ora 09.35' Personal rreth moshave 55 vjeç dhe 49 vjeç dalin nga lokali pa emër dhe vazhdojnë punën tek loka ngjitur lokalit.*
*Ora 09.48' Konstatohet nga ana jonë duke u parkuar tek lokali pa emër, automjeti i tipit Volvo ngjyra gri me targë AA 408 SS, me drejtues shtetasin Hajri Seferi dhe pasagjer një person i pa identifikuar nga ana jonë për arsye të pamjes së kufizuar. Nga automjeli zbret shtetasi Hajri Seferi takohet me shtetasin Petro (Abedin) Kuçi dhe bisedojnë në këmbë më njëri tjetrin. Në këtë moment afrohet dhe parkohet automjeti i tipit Mercedes Benz ngjyra gri me targë AA 212 ST me drejtues shtetasin Diamant Kamberi i cili zbret dhe bisedon me shtetasit Hajri Seferi dhe Petro (Abedin) Kuçi.*

[shqiptarja.com]

*Ora 09.52' Shtetasi Diamant Kamberi ndahet nga shtetasit Hajri Seferi dhe Petro (Abedin) Kuçi hipën në aulomjetin mercedes benz, ngjyre gri, me targë AA 212 ST dhe vazhdon lëvizjen në rrugën "Dardania " ku nuk mbahel nëvëzhgim nga ana jonë.*
*Ora 09.57' Shtetasi Petro (Abedin) Kuçi ndahet nga shtetasi Hajri Seferi hipën në automjelin me targë AA 301 RJ dhe vazhdon lëvizjen në rrugën "Dardania" ndalon dhe parkon tek hotel "Real Park" zbret dhe futet në ambientet e brëndëshme. Në këtë moment shtetasi Hajri Seferi hipën në automjelin me targë AA 408 SS dhe vazhdon lëvizjen në rrugën ''Idunstriale ", në rrugën nacionale Kashar - Maminas.*
*Ora 10.16' Automjeti me targë AA 408 SS ndalon dhe parkon ngjitur me hotel "Arli" përballë nji berberhane zbret shtetasi Hajri Seferi dhe pasagjeri një person rreth moshës 30 vjeç, me flokë bjond, i veshur me një bluze ngjyra e zezë, dhe pantallona xhinse ngjyra e zezë.*
*Ora 10.54' Shtetasi Hajri Seferi hipën në automjelin me targë AA 408 SS dhe vazhdon lëvizjen në rrugën dytësore që të çon në qytetin e Shijakut ku nuk mbahet në vëzhgim nga ana jonë për arsye dekonspirimi.*
*Ora 11.15' Nga ambientet e brëndëshme të hotel "Rel Park" del shtetasi Petro (Abedin) Kuçi, bashkë me personal e gjinisë femërore rreth moshave 34 vjeçe dhe 12 vjeçe dhe një person rreth moshës 32 vjeç, me flokë të zeza, i veshur me një bluze ngjyra e bardhë dhe pantallona xhinse blu, dhe hipin në automjelin me targë AA 301 RJ, si drejtues shtetasi Petro (Abedin) Kuçi, pasagjer në vendin para personi rreth moshës 32 vjeç, pasagjer mbrapa personat e gjinisë femërore rreth moshës 34 vjeçe dhe 12 vjeçe dhe vazhdojnë lëvizjen në rrugën "Dardania" dhe futen tek lokali pa emër ngjitur me mobilieri " Hendi", zbresin personat dhe futen në ambientet e brëndëshme të lokalit.*
*Ora 11.29' Konstatohet nga ana jonë duke u parkuar tek lokali pa emër, automjeti me targë AA 408 SS, me drejtues shtetasin Hajri Seferi, i cili zbret nga automjeti dhe qendron në këmbë, në këtë moment nga loakli del shtetasi Petro (Abedin) Kuçi dhe takohet me shtetasin Hajri Seferi.*

*Or a 11.33' Shtetasi Hajri Seferi ndahet nga shtetasi Petro (Abedin) Kuçi hipën në automjetin me targë AA 408 SS dhe vazhdon lëvizjen në drejtim të Vorës ku nuk mbahet në vëshgim nga ana jonë.*
*Ora 11.38' Në automjetin me targë AA 301 RJ hipën si drejtues shtetasi Petro (Abedin) Kuçi, pasagjer në vendin para personi rreth moshës 32 vjeç, pasagjer në vendet mbrapa hipin personal e gjinisë femërore rreth moshës 34 vjeçe dhe 12 vjeçe dhe vazhdojnë lëvizjen në rrugën nacionale Tiranë - Durrës - Fier - Tepelenë - Gjirokastër.*
**Procesverbali Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të kryer me datë 18.07.2018, ka rezultuar se: ,**
*Or a 09:38, Konstatohet automjeti i Abedin it tip volvo me targë AA 301 RJ brenda rrethimit të lokalit përballë karburantit "Star" në rrugën dytësore në afërsi të mbikalimit të Kasharit.*
*Ora 15:03, Konstatohet në rrugën "Myslym Shyri" përballë bar "Momo" i parkuar automjeti i tipit Volvo ngjyra gri me targë AA 408 SS.*
*Ora 15.05' Konstatohen shtetasit Hajri Seferi, Elton Shehaj (Drini) dhe shtetasi Baçi të ulur në ambientet e jashtme të bar ' 'Momo '*
*Ora 15:22, Personat ngrihen nga lokali ku shtetasi Elton Shehaj (Drini) vazhdon lëvizjen në këmbë dhe futet në nje rrugicë pa emër, ndërsa shtetasi Hajri Seferi dhe shtetasi Baçi hipin në automjetin me targë AA 408 SS dhe vazhdojnë lëvizjen në rrugën "Mysym Shyri ", në rrugën e "Dibrës ", ku ndalon tek shkolla e "Medreses ".*
*Ora 15:35, Automjeti me targë AA 408 SS me drejtues shtetasin Hajri Seferi dhe pasagjer në vendin para shtetasi Baçi vazhdon lëvizjen në rrugen e "Dibrës ", në rrugën "Ferit Xhajko ", në rrugën ''Dritan Hoxha" në rrugën nacionale Tiranë - Durrës.*
**Procesverbali Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të kryer me datë 27.07.2018, ka rezultuar se:**
*Ora 22:10, Konstatohen në rrugën ''Emin Duraku" pranë stadiumit "Selman Stërmasi" automjeti i tipit Volvo ngjyra gri me targë AA 408 SS i parkuar, dhe në këmbë duke biseduar shtetasit Hajri Seferi, Elton Shehaj (Drini) bashkë me dy persona te tjërë, personi i pare rreth moshës 45 vjeç, me flokë të zeza, i veshur me një bluze ngjyra e bardhë, dhe pantallona të shkurtëra ngjyra gri, personi i*

[shqiptarja.com]

*dytë rreth moshës 55 vjeç, me flokë pak të thinjura, i veshur me një bluze ngjyra gri e erret (i njëjti person që ishte më shtetasin Hajri Seferi me datë 07.07.2018 tek restorant Guri në Milot).*
*Ora 22:25, Shtetasi Hajri Seferi ndahet nga shtetasi Elton Shehaj (Drini) dhe hipën si drejtues në automjetin me targë AA 408 SS, në këtë moment personi rreth moshës 55 vjeç hpën si pasagjer në vendin para, personi rreth moshës 45 vjeç hipën si pasagjer në vendin mbrapa dhe vazhdojnë lëvizjen në rrugën "Vasil Shanlo" ku nuk mbahen në vëzhgim nga ana jonë. Ndërsa shtetasi Elton Shehaj (Drini) vazhdon lëvizjen në këmbë në rrugën "Gjin Bue Shpata" dhe futet në mabientet e brëndëshme të "Sushi Bar" ku ulet në një tavolinë vetëin.*

**Procesverbal Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të kryer me datë 30.07.2018, ka rezultuar se:**
*Ora 13:44, Komtatohet automjeti i tipit Volvo ngjyra gri me targë AA 408 SS në lëvizje në rrugën nacionale Fier - Levan me drejtues shtetasi Hajri Seferi dhe pasagjer në vendin para shtetasi Baçi ku vazhdon lëvizjen dhe ndalon tek bar restorant "A 4".*
*Ora 14:10, Nga bar restorant "A 4" dalin shtetasi Hajri Seferi, Baçi, Arten Liçi (Artan Memushi), dhe personi rreth moshës 58 vjeç dhe hipin në automjetin me targë AA 408 SS dhe vazhdojnë lëvizjen në rrugën nacionale Levan - Gjirokastër.*
*Ora 18:17, Konstatohen nga ana jonë në "Qaf Gjashtë" në lëvizje automjetet i tipit Volvo ngjyra e bardhë me targë AA 301 RJ me drejtues shtetasin Petro (Abedin) Kuçi dhe automjeti me targë AA 408 SS me drejtues shtetasin Hajri Seferi, pasagjer në vendin para personi rreth moshës 58 vjeç, pasagjer në vendin mbrapa shtetasit Baçi dhe Arten Liçi (Artan Memushi). Të dy automjetet vazhdojnë lëvizjen njëra pas tjetrës ku ndalojnë tek rrethi i "Delvinës" zbresin dhe bisëdojnë me njëri tjetrin në kembë për rreth 2 minuta.*
*Ora 18:20, Pasi përshëndeten me njëri- tjetrin shtetasi Petro (Abedin) Kuçi hipën në automjetin me targa AA 301 RJ dhe vazhdon lëvizjen në drejtim të qytetit Delvinës, ndërsa shtetasi Hajri Seferi hipën si drejtues në automjetin me targë AA 408 SS, pasagjer në vendin parë personi rreth moshës 58 vjeç, pasagjer mbrapa shtetasit Baçi dhe Arten Liçi (Artan Memushi), dhe vazhdojnë lëvizjen në rrugën nacionale Sarandë - Gjirokastër ku nuk u mbajtë më në vëzhgim nga ana jonë.*
**Procesverbali Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të kryer me datë 31.07.2018, ka rezultuar se:**
*Ora 18:55, Konslatohet nga ana jonë në ambientet e brëndëshme të bar kafe "Postoblloku" shtetasi Hajri Seferi i ulur në një tavolinë më dy persona, personi i parë rreth moshës 35 vjeç, me flokë të verdha, i veshur me bluze më vija lë bardha me kafe, dhe pantallona ngjyra gri, personi i dytë rreth moshës 25 vjeç, me flokë të zeza, i veshur me bluze ngjyra e zezë, dhe pantallona xhinse blu të shkurtëra (i identifikuar nga ana jonë si shtetasi Dervisjano Doku).*
*Ora 19:05, Nga bar kafe "Postoblloku" dalin shtetasit Hajri Seferi, Dervisjano Doku dhe personi rreth moshës 35 vjeç dhe hipin në furgonin e linjës Sukth - Shijak ku tek "4 Rrugëshi i Shijakut" zbresin nga furgoni dhe futen në ambientet e brëndëshme të bar "Eurolive", në këtë moment afrohet dhe parkohel një aulomjet i tipit BMV ngjyra e zezë me largë AA 700 RK, zbret nga automjeti personi rreth moshës 42 vjeç dhe futet në ambientet e brëndëshme lë bar "Eurolive" Më datë 02.10.2018, Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, kanë arrestuar në ftagrancë bashkëtëpandehurin në një procedim të lidhur, Darvisjano Doku. Kjo pasi gjatë kohës qëpo udhëtonte me automjetin tip Renault, me targa AA068UM, në drejtim nga Fieri në Lushnjë, në vendin e quajtur "Rotontoja e Savrës" Lushnjë, me pasagjer shtetasin Mariglent Gjoka, nga policia është ushtruar kontroll i personave dhe automjetit, ku ështësekuestruar njësasi lënde narkotike e llojit kokainë në masënprej 102.95gr.*

**Sipas procesverbalit Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të kryer me datë 14.09.2018, ka rezultuar se:**
*Ora 21:35, Konstatohen të ulur në një tavolinë në ambinetet e jashtme të bar ' 'De Niro" shtetasi Hajri Seferi bashkë me shtetasin Elton Shehaj(Drini) dhe automjeti tip volvo me targë AA 465 UC i parkuar në parkimin e këtij lokali.*

[shqiptarja.com]

**Sipas procesverbalit Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të kryer me datë 24.09.2018, ka rezultuar se:**
**"** *O Ado çfarë bëre? /O Deno nga ora 04 po nisem /do të marrë në telefon /ok por skamë shumë interes /po mirë më thuaj ti theme /ok ose më thuaj që të bëjë telefon që po nisem ose jo /ok.*
Me datë 28.08.2018, ora 22:19, i pandehuri Mario Zeqiri nëpërmjet numrit celular të tij, 0672847170, ka bërë biseda telefonike me numrin 0695237679, me këtë përmbajtje bisede:
*"O Deno Xhimi jamë!!!! /Në shtëpi je???? /Jo jamë tek lokali....a të vijë pesë minuta apo jo????????f Hajde /e mirë se tek puna jamë..*
*Me datë 03.09.2018, ora 12:48, i pandehuri Mario Zeqiri, nëpërmjet numrit celular të tij, 0672847170, ka komunikuar me sms me numrin 0694075827, me këtë përmbajtje: "O Den po mundohem ti boj them se lë marojë punë kto ditë.. ".*
Nga përgjimi i bisedave telefonike të të pandehurit Orges Jahelezi ( i thirrur Tani) rezulton se me datë 06.01.2018, ora 02:58, i pandehuri Orges Jahelezi, nëpërmjet numrit celular të tij, 0693919999 ka bërë biseda telefonike me numrin 0692860790 me këtë përmbajtje:
*"790: Haaaa/ 999: hë vlla/ 790: Dun naj kshu o burrë, se më thanë hajde kal, kalo...do kaloj mbrapa te Amsterdami të pimë ndonjë kafe...dune një 2—30 mije leksh klo../ 999: ha mirë, hajt ok, hajde s'kaproblem ...t/ 790: Hajt...* **"**
Me datë 22.02.2018 i pandehuri Orges Jahelezi ka bërë biseda telfonike me personin që përdor numrin 0698888879 me këtë përmbajtje:
*999: Je ke Hoteli a /879: Ke Amsterdami/ 999 Aaa a, a nuk i bane ato paketat a ke ash...të...mjaltit/ 879: Ah/ 999: Se lypi njani dy copa/ 879: pakela/ 999: Eh/ 879: Po/ 999: A I kea ty a/ 879: Jan te hoteli/ 999: Po thash mos i ke qitash se jam ka iki për Lezhë, ...me lek 1 kam thënë 35 euro copën ai ke thënë qaq/ 879: Po pra pop o puna asht me I marre ke hoteli veq/ 999:Po a po qo Lorin qitash/ 879: Hajt/ 999/Qoje pak shpejt/879: E ku me tis jell/999: ...aji rrethi 1 doganes aty po takohna me la ' '.*
Me datë 02.01.2018, ora 21:23, i pandehuri Orges Jaelezi ka komunikuar me të pasndehurin Jasin Kala,ky i fundit përdor numrin celular 0699286489, me këtë përmbajtje bisede:
*489: Jo kot lë mora thash/999: ...Jo o vllai ktu te lagjia jam/ 489: mir ja bo...qetsi eshte...kto 2-3 ditë ksho osh/ 999:...haaa mir shpirt... hajde se ndigjohena../489: Mire pra mire.../999:..hajt pra.../489: hajte pra se po ashtu...ndonje dite do ikim anej he/999: Po kur te dush, gati me ke/489: Mirë pra,*

[shqiptarja.com]

*hajte se do leme mbas... te rrime nja 2-3 dite sa te qetsohet pak../999: Kur te dush me ke gati/ 489: Mire vella. /999: Hajt.../489? Hajt pra naten, te Jala bej... ”.*
Me date 20.01.2018, ora 13:03, i pandehuri Orges Jahelezi ka bërë biseda telefonike me të pandehurin Jasin Kala me këtë përmbajtje bisede:
*999: he Cino/489: si ja kalove/999: hie mire, ca bane/489:hic, ja sa kam ardh ne Durres e po ha i cike buke/999; Ishe ne Tirane/ 489: Po, aty isha ne mjes/999: at takuat kend/489: Po pra e takova Paridin,beme muhabet dhe e lame me u taku prap, hajt ma./999: Ishalla po behet ndonje gje/489: Po ishalla po behet me nje jjale a kupton. A ishe gjume ee/999:po perzoten/489:erdhi pak edhe Xeni, edhe iku...hajt ma mir mire..ka do jesh/999:po verdall ketej jam '*’.
Me datë 03.03.2018, ora 15:46 i pandehuri Orges Jahelezi ka bërë biseda telefonike me të pandehurin Jasin Kala me këtë përmbajtje bisede:
'*'999: ku je o gjigand/489: ca ban, ku je ti/999:une kot verdalle, ja/ 489: une isha mbreme andej, 1 rash ziles/ 999.mbreme nuk kam dale fare, kam qene ne ship mbreme/489: epo mire, une ne Durres jam, isha ne Tirane, sa erdha/999: O vlla ku je ne Durres, tek lokali/ 489: las hi po iki tek lokali me taku dy shake se po me presin atje edhe, ku je ti ne Durres ee/999: Jo jam ne Tirane e thashe po vij te takoj/489: ITajde dhe takojme, ku te duash ti, ktu, atje, ne Shijak ku te dush/999: Une desha me ardh ne Shijak, mbaro punet e me be telefon/489: Mire pra, hajde ne Shijak/999: ok hajt ’’.*
Në orën 16:42 të asaj date, të pandehurit Orges Jahelezi dhe Jasin Kala kanë bërë këto biseda telefonike:
‘*'999: He Cini/489: Ho mo, do vish ti a jo/999:Po, po, do vij te te takoj patjetre/489: Per sa vjen ta di une? Se une jam ne Durres./999: Ku di une per Shijak.. 489: ...Joo, une ...une...ti nisu se une per pese minuta e kam.999: edhe une jam me makine....dhjete minuta jam para teje/489: Hajde se po nisem, per pese minuta nisem une/999:Hajde se do vij une, hajde.../489: Haj...haj...afer shpise atje.Ae ai lokali.../999:po, haj/489: ..haj”.*
Në orën 17:26 të po asaj dite mes të pandehurve Orges Jahelezi dhe Jasin Kala janë bërë këto biseda telefonike:
*"999: o vlla ku je/489:une ketu tek kater rruget jam, ti?/999:une, tek shtepia jote/489:ja dy minuta tek kater rruget jam ’ ’.*
Gjatë kontrollit të banesës së të pandehurit Orges Jahelezi, në qytetin Tiranë, me datë 21.10.2018 në orën 23:30, i është gjetur dhe sekuestruar një sasi Iënde narkotike prej 0.4 gr. e llojit kokainë. Nga akti i ekspertimit toksikologjik nr. 2526 datë 25.10.2018, ka rezultuar se në urinën e shtetasit Orges Jahelezi u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të kokainës në organizmin e njeriut.
Nga hetimi ka rezultuar se i pandehuri Ardit Gjyriqi, duke qenë punonjës policie në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës, kundrejt veprimeve në kundërshtim me ligjin, ka bërë kalimin e personave në kufi me Kosovën, të cilët kanë rezultuar me probleme, me pa të drejtë hyrje dhe dalje në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto veprime të kundraligjshme i pandehuri Ardit Gjyriqi i ka kryer,qoftë në rastet kur ai është në detyrë gjatë orarit të punës apo edhe në kohën kur nuk është në orar të punës, duke telefonuar kolegët e tij, për të cilët vazhdojnë hetimet.
Bisedë e dates 28.12.2017, ora 13:40:49, mes të pandehurit Ardit Gjyriqi nëpërmjet numrit celular 0698435888 me personin me numrin 066378888:
*"8888: Mezi kalova, 5888: pse mezi kalove, 8888:Po se tha për tjetërsim dokumenti futesh n' ’burg tha edhe do presësh aly, 5888: Po normal, 8888:Shofim tha atje me probleme apo jo, 5888: Po ai the ti emrin tim, 8888: Jo si thashë gja, 5888: Pse, 8888: Po smë the, ku dija unë, 5888: Si, 8888: A t ’i them tani se do kaloji dhe Seda, 5888: Po ti, hë mo Zot i Madh, shiko, shko aty, 8888: He, po, 5888: Shko ke polici, kap i polic edhe thoji që unë jam një mikesha e atije, thuje kam ngatrru dokumentin me shoqen time dhe ajo është tu ardhë mrapsh, ashtu tu ardhe...me dokumentin limin, ynë kam dokumentin e asajt, ia ku asht thuje...8888: I thashë si ti them kur t 'kalosh.,.5888: Shko thuju vete ti, aty shko thuje emrin tim, se sflas unë n’telefon policve ose ma jep me telefon tatin tjuflas, 8888: Okeji mirë”.*
Bisedë e datës 14.01.2018, ora 14:27:03 e bërë mes të pandehurit Ardit Gjyriqi nëpërmjet numrit të tij 0698435888 me personin që përdor numrin 0692484369:
‘ *’888: Ha mos shok, 396: Sqenke ktu ti, 888: Ehhh, leja kamarierit aty, sa sa leke ke sjell, 396: kamarierit ktu mrena, 888: Po, thuje janë për Albanin, thuje e Arditin, 396: për Albania, 888: Po, për Albanin thuje, sësht problem, 396: E mirë, dëgjo mu, 888:He, 396: 100 mijë lek kam sot unë, tjerat do*

[shqiptarja.com]

*ti bje me nja dy-tre ditë qinshen tjetër, 888: Mirë, leja ahtu kamarierit, 396: Albanit eh, 888: Po, Albanit thuje haj".*
Nga transkriptimi i përgjimit të bisedave telefonike të bëra nga i pandehuri Ardit Gjyriqi, i cili ka në përdorim numrin celular **0698435888,** rezulton se me datë 12.04.2018, në orën 12:36, personin nën hetim Ardit Gjyriqi, e ka telefonuar personi me numrin celular 0693888647, me këtë përmbajtje përgjimi:
**"** *Ku t'i lë, t'i lë këtu tek Gulfi,... ok., do të dalësh për Tiranë..jo shoku jam pa patentë, çfarë të bëj... "*
Bisedë e datës 15.04.2018, ora 08:11:23 bërë mes të pandehurit Ardit Gjyriqi nëpërmjet numrit cellular 0698435888 dhe personit që ka në përdorim numrin 38649300767 :
*"888: mirmengjes, 767: cfare bone?, 888: si kalove, 767: ke ardh ti vella?, 888: a he.., 767: ai shoku jame...që ikëm atë ditë me kerrë bashkë...888: ah..767: që përcollna...888:ah, se spo më kujtohesh...767: ai o vlla që më morën patentën...888: Po more vëlla, çfarë bëre?, 767: hiç mirë...ku je?, 888: tek puna, sa erdha.,767: për sa je aty?, 888: sa të ndërrohena, 767: ndërrohu dhe erdha vëllai jote...888: hajde knena, ku je ti?, 767: jamë këlej se më ka hupë njëra targë e makinës dhe spo më lënë me ikë për shtëpi.,.888: spo të lënë me hy? 767: /camë ngelur këtej matanë aty ku isha atë ditë...888: hajde këmbë këtej një herë pimë kafe dhe atëherë flasim, 767: hajde vëllai ime..*
Bisedë e datës 24.05.2018, ora 13:39:52 mes të pandehurit Ardit Gjyriqi që përdor numrin 0698435888 me personin që përdor numrin 0692020453:
*"888:alo, tungjatjeta.,453: tungjatjeta...888: a je burri fortë..453: çfarë është kjo burrnija që më përmende, më përmend burrni e gjona aty.. unë jam jashtë shtetit, kur të vijë të bëjë telefonon...888: po mirë more burrë thashë se mos je këtu...453: unë kam djalin në burg o ti shoku...e para, e dyta ti më ke bërë një nderë...që ne skemi bërë pazarë fare bashkë...të kam thënë do të bijë një makinë...në qoftë se mundem me ta pru...ne qoftë se e mb an mend...edhe e di ti çfarë makine kam pasë me të pru.jo makinë të r re guilt... kur të vijë do të bëjë telefon dhe do të japë kafen tate...888: po mirë more shoku, 453: më erdhi shumë keqe kjo puna e burrnisë..888: a të kam bërë ty ndere.. a të kam thënë gjë... jam edhe unë në halle...453: avash ti shoku, se ti më ke bërë një nderë.,888: nuk të kam bërë një nderë, por të kamë bërë njëpunë ...një punë për vete, një punë për ty...dakort..453: dëgjo mua...ti ske bërë asnjëpazarë me mua... dhe unë të kamë thënë do të bi një makinë...888:si bëje telefonit fare, kurrë për ato eke, as për kurrë gjë...unë e kam një hallë, më duhen do lekë...ke mundësi...ske thuaj skamë...453: asnjë lloj mundësie, unë jam në Gjermani...kam treqind halle...888: edhe unë kam një hallë të madhë, nuk dijta kujte me i ra telefonit..453: tashe nuk kam çfarë me të bë...888:kur s 'pate çfarë me thënë, unë e bëra blic për ty atë natë...a e bëra blicpër ty atë natë..453:kur të vijë do të bëjë telefon...888: mos e harro figurë, burrnija këto...453: po s 'ke bërë namin more...888: s 'kam bërë namin por a duhet mi japësh lekët ti mue?...453: sa lekë të kam unë ty?..888: jo, sipas teje kjo ngele tek ti..453: do të bëjë një makinë ...puna e makinës iku..kur të vijë një 2000 eurdosh do ta japë si gjithë të tjerëve...ti do me vu gjobë...888: unë s'kam bërë pazar me ty...453: s'ke bërë pra...888: ti ke thënë për golf* **7** *dhe 2000 euro.,453: të kam thënë golf* **7** *të dopjume...për aq punë sa ke bërë ti të japë golf 7 dhe 2000 euro...çfarë të dukem unë ty...shko ore në punë tëne...kur të vijë të japë 2000 euro...888: mirë '*

Me datë 23.07.2018, ora 18:22, i pandehuri Ardit Gjyriqi, nëpërmjet numrit celular të tij, ka bërë biseda telefonike me personin e paidentifikuar, me numrin celular 0699286497 me këtë përmbajtje bisede:
**"** *O Ardito, ku je tani fiks ti?/ Sa kalon Drejtorinë e Policisë/ Ne jemi në bllok tani/" Pastaj e orjenton se ku mund të takohen dhe lënë diku lek ish-ekspozita.*
Me datë 27.07.2018, ora 15:26, i pandehuri Ardit Gjyriqi, nëpërmjet numrit të tij, 0698435888, ka bërë biseda telefonike me personin me numrin 0673646035. Gjatë këtij komunikimi, i pandehuri Ardit Gjyriqi e pyet nëse është i regjistruar shtetasi kosovar Besim Mahmuti.
**"** *Ma shiko nëse ka hyrë sot?/ Hyrje e fundit e ka me 12 korrik/ Është nja 67 vjeç/ Njai është/ Nuk ka dalje/ E njeh si fytyrë?/ Jo nuk e njoh por më pyet një miku imë "*
Me datë 24.09.2018, ora 11:06, i pandehuri Ardit Gjyriqi nëpërmjet numrit celular të tij, 0698435888, i ka dërguar sms personit të paidentifikuar që përdor numrin celular 0693656350, me këtë përmbajtje: " 069400002l...numri 0698435888".

[shqiptarja.com]

Me datë 25.09.2018, ora 11:00, i pandehuri Ardit Gjyriqi në përmjet numrit celular të tij, 0698435888, i ka dërguar sms personit të paidentifikuar me numrin celular 0682597507, me këtë përmbajtje: "*Lali, e ka të ndaluar per 10 vjetë shengenin ai kusha nga Franca*".
Gjithashtu, rezulton se me datë 15.04.2018 nga Kosova në drejtim të Shqipërisë, nga Pika Kufitare Morinë Kukës, kanë udhëtuar shtetasit Blerim Gashi dhe Flamur Gashi, me automjetin me targa KS03447EP. Këta shtetas janë ndjekur nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore në Morinë Kukës, ku rezulton se personat në fjalë janë pritur nga i pandehuri Ardit Gjyriqi në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë dhe më pas është ushtruar kontroll në automjetin e tyre në afersi të Krujës, ku janë gjetur dhe sekuestruar një sasi prej 1.5gr lëndë narkotike kokainë.
Në bazë të aktit të ekspertimit kimik nr. 5030, datë 09.05.2018, ka rezultuar se nga analiza me GC/Ms, për pluhurin objekt ekspertimi, tregoi për praninë e kokainës.
**Nga procesverbaii Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të kryer me datë 15.04.2018, ka rezultuar se:**
*Ora 10:00, Komtaiohet automjeti i tipit Audi A 8 ngjyra e zezë me targa 03447 EP me drejtues një person rreth moshës 36 vjeç, me jlokë të zeza, i veshur me një bluze ngjyra blu, pasagjer në vendin e parë një person rreth moshës 33 vjeç, me flokë të zeza me mjekër, i veshur me një bluze gjyra e zrzë të cilët vazhdojnë lëvizjen në rrugën nacionale Morinë - Kukës — Rreshen.*

*Ora 10:20, Automjeti me targa 03447 EP ndalon tek një karburant "Dukagjini 2001", zbresin dy personal nga automjeti dhe ndërrojnë vendet ku personi rreth moshës 33 vjeç me mjekër kalon si drejtues automjeti, ndërsa personi rreth moshës 36 vjec hipën si pasagjer në vendin e parë dhe vazhdojnë lëvizjen në rrugën nacionale Kukës - Rreshen - Milot - Laç.*
*Ora 11.15' Sa kalon mbikalimin e qytetit te Laçit rreth 2 km ishte Postoblloku i Policisë i shërbimeve të Task Forcës së Qarkullimit rrugor, të cilët i bën shenjë për të ndaluar automjetit audi me targa 03447 EP, i cili nuk ndalon dhe vazhdon lëvizjen në drejtim të qytetit te Fush Krujës. Punonjesit e policisë ishin të pajisur me radar dhe një nga pjestaret e grupeve të vëzhgimit ishte bashkë me ta. Automjeti vazhdoi rrugën duke lëvizur me shpejtësi dhe duke bërë parakalime.*
*Ora 11:25, Automjeti audi, ngjyrëq e zezë, me targa 03447 EP ndalon tek karburant "Gega Oil" në Derven, në atë moment pas komunikimit me specialistin e Seklorit për hetimin e Narkotikëve....,u ndërhy nga ana jonë dhe u bë ndalimi i shtetasve të cilët ndodheshin në automjet të cilët u identifikuan nga ana jonë si shtetasit:*
**24.** *Flamur Gashi, i biri i Mehmtit i datlindjes 11.09.1980,lindur e banues Derven-Krujë.*
**25.** *Blerim Gashi i biri i Mehmetit i datlindjes 21.03.1984, lindur e banues Dei'ven-Krujë.*
*Automjeti me targa 03447 EP bashkë me personal në bashkëpunim me shërbime të qarkullimit rrugor të Komisariatit të Policisë Krujë të cilët ndodheshin në momentin e ndalimit u shoqëruan në Stacionin e Policisë Fushë Krujë. Gjatë kontrollit personal paraprak në momentin që shtetasit do të dërgoheshin në dhomat e shoqerimit shtetasit Flamur Gashi iu gjet në kuletë një sasi qese e vogël plastiker e tejdukshme, me material të bardhe në trajtë pluhuri, lëndë narkotike e llojit Kokainë, shtetasi Blerim Gashi i cili ishte drejtuesi i automjetit paraqiti dokumentacionin e automjetit dhe rezultoi që nuk kishte leje drejtimi me vete, pasi i ishte bllokuar nga shërbimet e qarkullimit rrugor për shkelje të kodit rrugor.*
Nga hetimi rezulton se i pandehuri Admir Hoxha, i cili ka përdorur numrin celular 06998000111, ka patur komunikime telefonike me të pandehurin **Hekuran Hoxha** dhe ky i fundit ka patur komunikime me të pandehurin Saimir Gjepali. Gjatë veprimeve hetimore të kryera ka rezultuar se i pandehuri Admir Hoxha ka pritur dhe takuar dy shtetas turq dhe një shtetas kosovar, konkretisht shtetasit Iskender Sale, Nedjet„Cesuroglu (alias Lavdim Nimani) dhe Xhemal Shala, tek hoteli i tij në Rinas, Tiranë dhe pas këtij takimi janë nisur me një furgon për në Kukës. Personat sa më sipër janë mbajtur nën vëzhgim dhe survejim, Nga veprimet e kryera rezulton se i pandehuri Admir Hoxha ka komunikuar dhe bashkërenduar me shtetasit turq Iskender Saleh, Nedjet Cesuroglu (alias Lavderim Limani) dhe shtetasin kosovar Xhemal Shala, të cilët kanë sjellë në Republikën e Shqipërisë lëndën e parë për prodhimin e heroinës dhe kokainës, ndërkohë që të pandehurit, Admir Hoxha, Hekuran Hoxha, Flamur Çelaj, Xhevit Shuti në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të grupit kriminal kishin përgatitur ambientin dhe laboratorin për përpunimin dhe prodhimin e lëndës narkotike tek banesa e personit nën hetim Xhevit Shuti në fshatin Brenogë të Rreth it Has.

[shqiptarja.com]

Me date 18.10.2018, ora 16:40,(edhe pse në vijim të hetimeve në kuadrin e procedimit 339 të vitit 2016, por Drejtoritë vendore nuk janë vënë në dijeni mbi ekzistencën e këtij procedimi në mënyrë që të mos dekonspiroheshin hetimet e grupeve sa më sipër) nga Policia Gjyqësore janë informuar se në banesën e të pandehurit Mustaf Shuti (e ndodhur në fshatin Brenogë), kishte lëndë të kundraligjshme e dyshuar si narkotike, si dhe janë sinjalizuar mbi ekzistencën e një "laboratori" për përpunimin e saj. Nga procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 18.10.2018 (ndërsa automjetet janë kqyrur në vijim edhe me datë 19.10.2018), ndër të tjera ka rezultuar se: gjatë këqyrjes në ambientet e jashtme te banesës së të pandehurit Mustaf Shuti, është konstatuar një automjet me targa AA 462AD, "MITSUBISHI" në pronësi të të pandehurit Xhevit Shuti. Ndërsa në anën veriore të këtij automjeti ndodhej një automjet tjetër i parkuar me targa DR 328A me ngjyrë të bardhë, tip BENZ 250, në pronësi të shtetasit Bashkim Hoxha, i cili rezulton të jetë babai i të pandehurit Admir Hoxha. Nga këqyrja e këtij automjeti janë gjetur dhe sekuestruar një sasi qesesh të tejdukshme në forme zarfesh. Po kështu në drejtim të oborrit të shtëpisë është gjetur një automjet i parkuar i tipit VOLSËAGEN me targa AA 660OC, ku në pjesçn e pasme të furgonit ndodhej një kuti e mbushur me ngjitës natriban me ngjyrë kafe. Automjeti ka rezultuar të jetë në pronësi të firmës "PAPA RENT' lëshuar për përdorim shtetasit shqiptar Fisnik Sadiku. Nga përpunimi me pluhur daktiloskopik alumini janë përftuar 4 gjurmë papilare të vlefshme për identifikim. Pas këtij automjeti ndodhej një tjetër automjet i parkuar me targa **AA 865IR, tip fugon BENZ,** i mbyllur ne pronësi te shtetasit Shkelqim Saraçi. Nga këqyrja në ambientet e brendshme të automjetit janë konstatuar thasë te hedhura në mënyre të çrregullt 25kg të firmës "SIGECAM" me mbishkrimin "CARBONATIO DI SODIO", si dhe shishe me ngjyrë kafe, bidonë plastik të formave dhe përmasave te ndryshme.
Gjithashtu, pas furgonit janë gjetur edhe 9 bidonë plastik të bardhë të formave dhe përmasave të ndryshme të mbushura me lëndë të lëngshme si dhe një bidon rreth 30 kg i mbështjellë me plasmasë me ngjyrë blu. Po kështu, është gjetur një divan përballe shtëpisë, doreza plastike, maska sterile, furça boje etj. Ndërsa në një ambient të përshtatur si dhomë gatimi afër shtëpisë së të pandehurit Mustaf Shuti, janë gjetur 10 bidonë plastik të mbushura me lëndë të lëngshme me mbishkrimin 'ACID PISHIN", një valixhe udhëtimi në të cilën ndodheshin 14 pako të mbështjella me natriban në të cilën kishte lëndë narkotike e llojit heroinë, një bombël gazi e shoqërisë "GAZ SHA" me një tub që përfundonte në një furnele gazi, një palë doreza të gomuara, një gotë qelqi.
Në vijim të këqyrjes ka rezultuar se pas kësaj dhome ndodhej një ambient në të cilin ndodheshin disa fuçi të mëdha plastike me ngjyrë kafe dhe një fuçi tjetër plastike me ngjyrë blu në të cilat kishte lëndë të lëngshme. Në këtë ambient është gjetur edhe një lëndë ngjitëse me ngjyrë të zezë. Nga ekspertimi kimik ka rezultuar se pas ekzaminimeve në aparatin FTIR, rezultoi se në lëndët e gjetura në furgonin tip BENZ, me targa AA 865IR, rezultoi prezencë e "anhidrik citrik", dhe një lëndë tjetër "DIETIL ETER".
Gjithashtu, nga këqyrja e banesës, në ambientet e brendshme të saj është gjetur një sasi prej 161 pako të mbështjella me natriban e mbushur me lëndë narkotike e llojit heroinë. Gjatë këqyrjes së banesës janë gjetur edhe disa karta "Raiffeisen bank'" të të pandehurës Anila Shuti, kartë identiteti në emër të të pandehurës Anila Shuti, kartë identiteti i shtetasit Idajet Shuti, mastër kard Raiffeisen bank në emër të të pandehurit Xhevit Shuti, Kartë Raiffeisen bank, Idajet Shuti, pasaportë në emër të të pandehurit Xhevit Shutit, telefon i markës XIOM1, leje drejtimi, kartë identiteti, kartë banke në emër të të pandehurit Flamur Çelaj, një palë çelësa audi, Ipad, USB etj.

Gjatë këqyrjes janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale, automjeti tip BENZ me targa DR 328TX më ngjyrë të bardhe, librezë për instrumentat matëse DR 328 A në emër të shtetasit Bashkim Hoxha, Çertifikatë pronësie për automjetin me targa DR 328TX në emër të Bashkim Hysen Hoxha, leje qarkullimi për automjetin me targa DR 328TX në emër te Bashkim Hoxha, automjeti me targa AA 660OC, tip VOLSËAGEN, në pronesi te firmës PAPA RENT, lëshuar për përdorim shtetasit shqiptar Fisnik Sadiku, faturë shitje tatimore lëshuar nga Ervin Lici për shtetasin Turk, Kuscu Ozgur Ohder, çertifikatë e kontrollit teknik për automjetin me traga AA 660OC, policë sigurimi e mjetit targë AA 660OC, leje qarkullimi për automjetin me targa AA 660OC, automjet me targa AA 865IR, tip BENZ, në pronësi të shtetasit Shpetim Saraçi, leje qarkullimi për automjetin me targa AA 865IR, çertifikatë e kontrollit teknik për automjetin me targa AA 865IR, policë sigurimi për automjetin me targa AA 865IR, automjeti me targa A A 643UP, në pronësi të të pandehurit Flamur Çelaj, leje

[shqiptarja.com]

qarkullimi për automjetin me targa AA 643UP, çertifikatë pronësie në emër të të pandehurit Flamur Çelaj, çertifikatë e kontrollit teknik, kontratë shitblerje në emër të të pandehurit Flamur Çelaj, qese transparente të madhësive të ndryshme në formë zarfa me përmasa 25x30cm dhe 25x34cm, pesë bidone plastik me ngjyrë të tejdukshme 0.5L të gjetura në automjetin me targa AA 8665IR, qese me farë me ngjyrë te zezë, 9(nëntë) bidona plastik të bardhë të formave dhe përmasave të ndryshme, bidon plastik i mbushur me lëndë të lëngshme, dy palë syze plastike, dy palë doreza trikotomi, katër palë furçe boje, tre copë shpatulla plastike, pesë maska sterile, një kuti me natriband, gur fresibël, kazan inoksi me mbishkrimin ARIAN, dhjetë bidona plastik me përmasa 45x26x28cm, me mbishkrimin "ACID PISHIN"' të mbushura me lëng, ku njëri është i zbrazur, një bidon plastik me 3L i mbushur më lëndë të lengshme, tre fuçi plastike me ngjyrë kafe, një fuçi me ngjyrë blu, njëqind e shtatëdhjetë e pesë pako me përmasa 20x8x8cm, të mbështjella me natriban të mbushur me lëndë narkotike në **sasinë 182.5 kg, të llojit heroinë,** lëndë e lëngshme sasinë 19.2 litra, lëndë ngjitëse në sasinë 1.56kg, tre valixhe që shërbenin për ambalazh të lëndës së dyshuar narkotike, dy pako me celefon me nga njeqind pjata plastike me ngjyrë të bardhë brenda, dy qese me celefon me nga njëqind luge plastike, dy peshore elektronike, arkë kartoni me mbishkrimin Belino, me 10 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë "dyhelyl ehter", arkë kartoni me mbishkrimin Marmo, me 11 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë "dyhelyl ehter", arkë kartoni me mbishkrimin Fritoloy, me 14 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë "dyhelyl ehter", arkë kartoni me mbishkrimin ngjyrë e zezë me shkronja greke, me 10 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë "dyhelyl ehter", arkë kartoni me mbishkrimin Crossant, me 11 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë "dyhelyl ether, arkë kartoni me mbishkrimin Deperibile, me 9 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë "dyhelyl ehter", arkë kartoni me mbishkrimin Reply, me 16 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë "dyhelyl ehter", arkë kartoni me mbishkrimin Belino, me 11 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë "dyhelyl ehter", arkë kartoni me mbishkrimin Molto, me 10 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë "dyhelyl ehter", arkë kartoni me mbishkrimin Reply, me 16 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë "dyhelyl ehter", arkë plastike me ngjyrë të zezë, si ajo e perimeve, e cila ka 12 copë shishe me etiketë "dyhelyl ehter", 3 kuti kartoni, me ngjyrë kafe,me numër 61435, ku janë 11 bidona plastike, 2.5 litërsh me ngjyrë të bardhë, me etiketë aceton, dy kuti kartoni me etiketë Vër ku janë dhjetë copë shishe qelqi 2.5 litërshe me etiketë Hidroklerid acid, 14 copë bidona plastike, më ngjyrë të bardhë, 2.5 litërshe seicili, me etiketë acid sulfurik 96 gradë, 11 copë bidona plastikë të bardhë 2.5 litërshe me etiketë hidroklerid acid, 98 copë bidona plastikë të bardhe, 1 litërsh, me etiketë "dyethylether", 2 copë shishe qelqi 2.5 litërshe me etiketë "aceton", 7 copë bidona plastikë 5 litërsh, me ngjyrë të bardhë, me etiketë "aceton", si dhe objekte të tjera.

**Në bazë të aktit të ekspertimit kimik nr.13154, datë 24.12.2018, ka rezultuar se;**

-Analiza me GC/Ms dhe FTIR i pluhrave në 175 pakot objekt ekspertimi tregoi për praninë e morfinës.

-Për mungesë satndarti morfine, pluhrat nuk mund f i nënshtrohen analizës sasiore për të përcaktuar përqendrimin e morfinës.

-Analiza me GC/MS dhe Ftir për materialin e qeses C0013135 objekt ekspertimi, tregoi për praninë e heroinës.

-Analiza sasiore me GC/MS për materialin e qeses mer nr.serial C0013135 tregoi për praninë e heroinës në përqendrim mesatar 74.8%.

-Analiza me GC/MS për materialin e qeses me nr.serial unik B0000667 tregoi për praninë e heroinës.

**Në bazë të aktit të ekspertimit kimik nr.665, datë 17.12.2018, ka rezultuar se:**

-Analiza me FTIR për lëngun me bidonat me mbishkrimin " PH Acid/t pishin" tregoi për praninë e anhidridit acetik.

-Anhidriti acetik klasifikohet në listën e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope të ligjit nr.8874, datë 29.03.2002.

-Anhidridi acetik klasifikohet në listën e lëndëve që përdoren për fabrifikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope tëdigjit nr.8874, datë 29.03.2002.

-Analiza me FTIR për materialin në thasët me mbishkrimin " Sodium carbonate", tregoi për praninë e karbonatit të natriumit.

-Analiza me GC/MS për lëngun në fuçinë bezhë 3 tregoi për praninë e kodeinës, acetil kodeinës, diacetil morfinës(heroinës), papaverines.

[shqiptarja.com]

-Analiza me GC/MS për materialin si ngjitës në lëngun e fuçisë me ngjyrë tulle me nr,8 tregoi për praninë e kodeinës, acetil kodeinës, diacetil morfines(heroinës), papaverines.
-Analiza me GC/MS për materialin si ngjitës në lëngun e fuçisë me ngjyrë tulle të numertuar 6/2 tregoi për praninë e e acetilkodeinës, 6momonoacetilmorfinës, diacetilmorfinës(heroinës), noskapines.
-Analiza me GC/MS për mbetjet e ngurta në pjesën anësore të fuçisë bojeqielli 6/2 tregoi për praninë e acetilkodeinës, 6monoacetilmorfinës, diacetilmorfinës (heroinës), papaverine, noskapines.
-Analiza me GC/MS për mbetjet në valixhen me nr. 15 tregoi për praninë e morfmës , diacetilmorfmës (heroinës).
-Analiza me GC/MS për mostrën 16/1 të valixhes me nr. 16 tregoi për praninë e diacetilmorfinës (heroinës).
-Analiza me GC/MS për mostrën 16/2 të valixhes me nr. 16, tregoi për praninë e acetilkodeinës, 6 monoacetilmorfinës, diacetilmorfinës(heroinës), noskapines.
-Analiza me GC/MS për mostrën 16/3 të valixhes me nr. 16, tregoi për praninë e diacetilmorfinës(heroinës).
-Analiza me GC/MS për mostrën e marrë në valixhen 17, nuk tregoi për praninë e ndonjë lënde narkotike.
-Analiza me GC/MS për mostrat me ngjyrë kafe në kapak e kusi të numërtuar me nr.18, tregoi për praninë diacetilmorfinës(heroinës).
-Analiza me GC/MS për mbetjet në mbështjelljet e mumërtuara me nr. 19, tregoi për praninë e kodeinës, morfinës, noskapinës.
-Analiza me GC/MS për mbetjet në objektin metalik dhe copën e kanaljeres të numërtuara me nr.20, tregoi për praninë e diacetilmorfinës(heroinës).
-Analiza me GC/MS për mbetjet në copën e napës të numertuar me nr.21, tregoi për praninë e morfinës, 6 monoacetilmorfinës, noskapines.
-Analiza me GC/MS për mostrat e marra në objektet e tjera, nuk tregoi për praninë e ndonjë lënde narkotike.
-Me reagentet anhidrid acetik, karbonat natriumi, ujë dhe morfinë, bëhet e mundur kalimi nga morfinë në heroinë bazike.
-Me këta reagente u bë e mundur prodhimi i heroinës bazike në kushte laboratorike.
-Nga literaturat e huaja dietileteri dhe acidi klorhidrik bëjnë të mnundur kalimin nga heroinë bazike në heroinë hidrokloride.
-Përderisa u gjet sasi heroine e sapo prodhuar( në gjendje të lagësht e pafiltruar mirë, e cila u tha më pas) tregon se procesi është realizuar.
**Në bazë të aktit të ekspertimit kimik nr.664, datë 17.12.2018 ka rezultuar se:**
-Lëndët kimike të përshkruara më sipër janë lëndë kimike të fabrikuara dhe analiza kimike e kryer tregoi për përputhje me emërtimin në etiketë për acidin klorhidrik, acidin sulfurik, aceton , dietileter.
-Acetoni, dietileteri, acidi klorhidrik, acidi sulfurik, klasifikohen në listën e e lëndëve që përdoren fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope të ligjit nr. 8874, datë 29.03.2002.
-Analiza me FTIR e lëndës në bidonat me ngjyrë të bardhë, me tapë të kuqe, pa etiketë, tregoi për praninë e dietileterit.
-Teorikisht acidi klorhidrik, acetoni, dietileteri, përdoren dhe si reagente në fazën në cilën bëhet e mundur kthimi i heroinës bazike në hidrokloride.
-Analiza me GC/Ms për lëngjet objekt ekspertimi, nuk tregoi për praninë e ndonjë lënde narkotike.
**Nga hetimi rezulton se lëndët dhe sendet e sekuestruara, të përshkruara më lart, në vendin e gjetur shërbenin për prodhimin e lëndëve narkotike si ajo e heroinës.**
Nga aktet e administruar rezulton se gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti kriminal kanë qenë pjësëmarrës shtetasit shqiptar, të pandehurit Admir Hoxha,Hekuran Hoxha, Xhevit Shuti, Flamur Çelaj,Vehbi Berushi, shtetasit turq Nejdet Cesuroglu, Iskender Sale, dhe shtetasi kosovar Xhemal Shala, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin dhe perdsona të tjerë që po hetohen në kuadër të procedimit penal nr.29 të vitit 2019(339 të vitit 2016), kanë vepruar në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Nga aktet rezulton se shtetasit turq dhe kosovar të lartpërmendur ishin personat që siguronin lëndën e parë për prodhimin e heroinës, e cila rezulton të jetë trafikuar nga jashtë shtetit, ndërsa kanë bashkëpunuar më tej me anëtarët e e tjërë të grupit kriminal, të pandehurit Admir Hoxha, Hekuran Hoxha, Flamr Çelaj, Vehbi Berushi, Xhevit Shuti dhe persona të tjerë ndaj të cilëve vazhdojnë hetimet, duke ngritur një

[shqiptarja.com]

minilaborator për prodhimin e lëndëve narkotike tek banesa e të pandehurit Xhevit Shuti, ku janë gjetur dhe sekuestruar sasi të mëdha prekursorësh për përgatitje të lëndëve narkotike.
Nga kontrolli i ushtruar tek ambienfët e banesës së të pandehurit Hekuran Hoxha, (sipas procesverbalit të datës 21.10.2018, ora 16:00) janë gjetur dhe sekuestruar një presë metalike, me përmasa 20x10cm, me kapakë dhe bazament të çmontueshëm, që shërben për paketimin e lëndës narkotike të llojit heroinë.Nga akti i ekspertimit kimik nr. 1339, datë 31.12.2018, ka rezultuar se në presën metalike, objekt ekspertimi, analizat me GC/MS treguan praninë e heroinës.
Nga vëzhgimi i lëvizjes së subjekteve të dyshuara gjata ushtrimit të këtij aktiviteti kriminal, nga procesverbali "Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të datave 16.10.2018-18.10.2018, janë mbajtur në mbikëqyrje lëvizjet e të pandehurve Admir Hoxha.
Kështu me date 16.10.2018, ora 09:43, rezulton se automjeti tip Audi me targe A A 485 SN i cili drejtohej nga i pandehuri Admir Hoxha, tek rreth rrotullimi në afërsi të Aeroportit Nënë Tereza, ku pas tij qëndron automjeti tip Volsvagen ngjyrë gri me targa AA 660 OC, i drejtuar nga një person i moshës 48 vjeç,të cilët në orën 09:45, parkohen tek kompleksi ADOR RESORT. Në orën 09:55, i pandehuri Admir Hoxha dhe personi tjetër kanë lëvizur me automjetin me targa AA 660 OC, në drejtim të Kukësit, të cilët janë takuar edhe me persona të jerë.
Me datë 17.10.2018, është dokumentuar lëvizja e të pandehurit Admir Hoxha, ku nga Hoteli ADOR RESORT lëviz me një tjetër person me automjetin tip Volsëagen ngjyrë gri me targa AA 660 OC, duke bierë mallra të ndryshme në zonën e Vorës dhe në afërsi të Tiranës, të cilët takohen me disa persona të tjerë, të cilët po atë ditë lëvizin në drejtim të qytetit Kukës, ku pasi kanë takuar të pandehurin Xhevit Shuti, në orën 16:30, janë vendosur në fashtin Brenogë të Rrethit Has. Në orën 19:04, ata janë nisur përsëri për në Tiranë, ku janë akomoduar në ADOR RESORT.
Me datë 18.10.2018, ora 13:34, ku janë nisur nga ADOR RESORT, janë konstatuar automjetet tip Volsëagen ngjyrë gri me targa AA 660 OC dhe tip Sprinter Mercedez Benz me targa A A 895 MU, duke lëvizur në drejtim të fshatit Brenogë, ku në orën 13:49, kanë mbërritur tek banesa e të pandehurit Xhevit Mustaf Shutit.
Të dhënat e rezultuara nga raportet e vëzhgimeve mbështeten edhe nga ato të rezultuara nga përgjimet telefonike të të pandehurit Admir Hoxha, Gjatë kësaj kohe, personi që ka përdorur numrin celular 0699522496 i ka dërguar sms të pandehurit Admir Hoxha tek numrit i tij 0698000111, me këtë përmbajtje " *I thuaj se për një orë e pres tek vendi ku u takuam kur të jem aty do të shkruaj por qeset ti anullojë nëse nuk janë siç i kërkove* **".**
Transkriptimi i përgjimit mes numrit 0698000111 dhe numrit 0699522496, (datë 16.10.2018 ) sms text: *"Po çdo e takosh ai më tha për nesër me taku* **".**
Transkriptimi i përgjimit mes numrit 0699522496 dhe numrit 0698000111, (datë 16.10.2018)      sms text: "*Nuk e paske lexuar mesazhin me duket e takova dhe e lamë që do ti sjell vetë në otogar tek alpari e takova krejt rastësisht në orën gjashtë e njëzet sa/po të shkrova ty.*
Transkriptimi i përgjimit mes numrit 0698000111 dhe numrit 0686039790 (datë 16.10.2018)      :
*+ 111: "nesër aaa, si kalove.. ka ora tetë e gjys mjesit ke lokali; +790: po re: +111: mundohu per nja dy tre ditë katër ditë maksimumi; +790: mirë mirë po marr plaqkat me vete pra, me çfarë të vij deri atje; +111; shif gjej noj makinë të rastit ndonjë furgon; +790: po mirë, po qe ashtu marr ndonjë shok të më bie deri atje; +111: ee me prit tu pi kafe atje, se unë jam me makinë te madhe, pranaj; +790: a është rruga e'dirë andej nga Rrinsi, e kalu; +111; krejt lirë është, çpunë ke në vorë, deri tek lokali vjet ti; +111: po* **".**
Transkriptimi i përgjimit mes numrit 0682568460 dhe numrit 0698000111, me datë 17.10.2018, sms text:
*"po vij në Tiranë jam në Vlorë je për kafe.*
Transkriptimi i përgjimit mes numrit 0698000111 dhe numrit 0682568460, me datë 17.10.2018 sms text:
*"ok takojm pak te Ringu se du me lëviz* **".**

Transkriptimi i përgjimit mes numrit 0699522496 dhe numrit 0698000111, me date 17.10.2018 ora 13:40 sms text:

[shqiptarja.com]

*"Përshëndetje cu bë me atë djalin Zahmet e he por lidhu njëherë me atë djalin se nuk ka ardhur akoma autobuzi edhe pak është gati për tu nisur".*
Transkriptimi i përgjimit mes numrit 0682644394 dhe numrit 0698000111, me datë 17.10.2018 ora 14:06, sms text:
*"Çkemisija kalon kurpopirn kafe/S'jam andejjam larg".*
Transkriptimi i përgjimit mes numrit 0698000111 dhe numrit 0697468041, datë 18.10.2018 ora 15:31:
*+ 111; a i largove krej dhe kasafortën/ +041: po po, +111: dërgoj tek të tjerat e di ajo ku janë të tjerat, +041: mirë.*
Po ashtu, nga transkriptimi i përgjimeve të bisedave telefonike të bëra nga i pandehuri Hekuran Hoxha, i thirur me emrin Roni,(kushëri i të pandehurit Admir Hoxha), i cili rezulton të ketë përdorur numrin celular 0693803333 dhe i pandehuri Admir Hoxha me numrin e tij 0698000111, me datë 30.08.2018, kanë rezultuar të dhënat më përmbajtje si më poshtë:
*"+333:Ka je/+111 :Hiq...në Tiranë/+333 e qa do bëjmë do takojmë sot/+111 :Po thanen e lamë me këtë shokun, tim se ka gjet ky ni ashtu aty n 'Durrës, që merr vesh nga këto letrat/+333:Okej ...rregullojmë njëherë lelrat....+333:Mirë ...shife vetë edhe ashtu, po me atë ke fol me të/+lll:Jo mor burr skam fol u ba nja një javë ni javë u ba/...hajl se folim nga afër".*
Me datë 14.08.2018 ka patur komunikime telefonike të të pandehurit Hekuran Hoxha me të dhënat si më poshtë:
Komunikime sms dërmjet numrit 0693086850, me numrin 0693803333 në përdorim të të pandehurit Hekuran Hoxha, me këtë përmbajtje sms:
"o *shokpo më vjen doripërdit/..kam për ti dhonë 800.. "*
Komunikime sms ndërmjet numrit 0698977784, në përdorim të të pandehurit Saimir Gjepali me numrin 0693803333 në përdorim të të pandehurit Hekuran Hoxha.
*"o shok në dark do shkoj te ai se nuk erdhi knej/hë shok a vonohesh/a ikim bashkë/1 tha do vij të takoj e kemi Ion në 9 e gjys për zotin/o shok ska ardh akoma* ".
Komunikime të dates 12.09.2018 të të pandehurit Hekuran Hoxha me sms, me numrin 0699638603.
*"Jam në Kosovë vij vonë nga darka. Komunikime të të pandehurit Hekuran Hoxha me numrin 0699638603 me personin tjetër me numrin 0693086850 ku ky i fundit i dërgon sms: "o rono më erdh dori ke puna osht dhy puna keq po sme dhe leket deri sonte neser i du gjyth me tha./e kam litarin nfyt/o shok a bane noj gjo per ate 500 pakten ti jap ate/Neser kismet shokZ".*
Me datë 14.08.2018 kanë rezultuar komunikime me sms të të pandehurit Hekuran Hoxha me numrin 0699638603 me personin tjetër me numrin 0698977784, ku ky i fundit i dërgon sms: *"Te them une se munt te hiki ne lezh me ket shokun dhe kthehem direkt ne tirane po nuk hika hi kirn bashke ".*
Me datë 14.08.2018, ka patur komunikime telefonike me sms mes të pandehurit Hekuran Hoxha me personin tjetër 0694077760, datë 14.08.2018:
*"amon mer shok te kishim maru pune se kam dal legen me ate e kam majt gjith diten tel te fik/+333 i kthen sms:*
*"ke te drejt/e di er shok kam dal dhe une legen me ty/sa te vij te mar unë*
Nga ekspertimi i telfonit celular të sekuestruar të pandehurit Hekuran Hoxha, ndër të tjera kanë rezultuar fotot e siguruara nga telefoni i tij Iphone 7 (A 1778),me të dhënat si më poshtë:
*Në fotot 1,4,6,7,11 dhe 13 evidentohet i pandehuri Hekuran Hoxha në shoqërinë e shtetasit turk Nejdet Cesuroglu.*
*Në foton 2 evidentohet i pandehuri Hekuran Hoxha në shoqërinë e shtetasit kosovar, të pandehurit Xhemal Shala.*
*Në foton 3 evidentohet i pandehuri Hekuran Hoxha dhe vëllai i tij, IImi Hoxha, në shoqrinë e shtetasit turk Nejdet Cesuroglu,*
*Në foton 8 dhe 9 evidentohen pasaportat e shtetasit turk Nejdet Cesuroglu dhe shtetasi kosovar Xhemal Shala.*
*Në foton 10 evidentohet nga e majat shtetasi Ilmi Hoxha, shtetasi kosovar, i pandehuri Xhemal Shala, shtetasi Eraldo Vora, i pandehuri Hekuran Hoxha, shtetasi turk Nejdet cesuroglu, si dhe shtetasit Ani Vora dhe Brusi Vora.*
*Në foton 12 evidentohet nga e majt a shtetasja Eraldo Vora, shtetasi turk Nejdet Cesuroglu, i pandehuri Hekuran Hoxha, si dhe shtetasit Ani Vora dhe Ilmi Hoxha.*

[shqiptarja.com]

*Në foton 14 evidentohet shtetasi turk Nejdet Cesuroglu*
*Foto 16 pasqyron numrin 355698000111, i cili ka qenë në përdorim nga i pandehuri Admir Hoxha, i gjetur i regjistruar në telefonin e sekuestruar të pandehurit Hekuran Hoxha.*
Sipas **transkriptimit të përgjimeve të datës 17.10.2018,** ndërmjet numrave 0698000111 në përdorim të të pandehurit Admir Hoxhës dhe numrit 0686755544, në kohën kur kishin ardhur shtetasit nga Turqia dhe shtetasi Kosovar cituar sa më sipër, me përmbajtje si më posshtë:
*"+111:alo o flori si kalove nesë vijnë ca miq të mij aty thuaju të ulen në kafe .../+544:do vijnë ca miq tuj dhe do shkojnë tek kafja.../+111: thuja të ulen tek kajja...+544:Adi erdhën këta Ire shokët unë po ju flas anglisht por spo më kuptojnë +11 l:mi jep në telefon/+544:po ".*
**Nga vëzhgimi i lëvizjeve të të pandehurit Admir Hoxha gjatë kohës së ushtrimit të aktivitetit kriminal, në bazë të raportit të vëzhgimit të datës 16.10.2018, kanë rezultuar të dhënat si më poshtë:**
*Ora 08:55, Konstatohet shtetasi Admir Hoxha duke dalë nga banesa, i cili takohet me një person të moshës reth 42 vjeç, i veshur me bluzë gri me kjpauç, mb ante syze opt ike. Personi i moshës rreth 42 vjeç i jep shtetasit Admir Hoxha një sasi kartëmonedhash, të dyshuara si euro me prerje 50.*
*Ora 08:57, Shtetasi Admir Hoxha ndahet nga personi i moshës rreth 42 vjeç, i cili hipën në automjetin tip Ford me ngjyrë gri me targa AA049MG dhe lëviz në këmbë në drejtim të lokal „ Picaso ", ku në ambientet e loklait takohet me një grua të moshës rreth 38 vjeçe...*
*Ora 08:58, Shtetasi Admir Hoxha së bashku me gruan e moshës 38 vjeçe dalin nga ambientet e lokal Picaso, ku gruaja e moshës rreth 38 vjeçe hipën në automjetin tip Ford AA049MG, ndërsa shtetasi Admir Hoxha lëviz në drejtim të banesës së tij.*
*Ora 09:00, Konatatohet shtetasi Admir Hoxha duke dale nga rrugica e banesës me automjetin tip Audi me ngjyrë të zezë, me targa AA485 SN dhe lëviz në drejtim të autostradës Tiranë-Durrës, ku kthen në rrugën për në Rinas.*
*Ora 09:33, Automjeti tip Audi AA485 SN hyn në kompleksin ''Ador Resort* **"** *që ndodhet në Rinas.*
*Ora 09:40, Konstatohet shtetasi Admir Hoxha duke dalë nga kompleksi ''Ador Resort", me automjetin tip Audi AA485SN, i cili lëviz në drejtim lë aerportit ' 'Nënë Tereza*
*Ora 09:43, Automjeti tip Audi AA485 SN qëndron pranë rrethrrotullimit ku mbas tij qëndron dhe një automjet tip Volsvagen furgon me ngjyrë gri, me targa AA660 OC, të cilin e drejtonte një person i moshës rreth 48 vjeç, i veshur me xhaketë të zezë dge pantallona të zezaza dhe flokët tullac. Të dyja automjetet lëvizin njëri pas tjetrit në drejtim të kompleksit* **'** *'Ador Resort ",*
*Ora 09:45, Automjetet tip Audi AA485SN dhe Volsvagen furgonAA660 C parkohen te kompleks ' 'Ador Resort".*
*Ora 09:55, Konstatohet shtetasi Admir Hoxha së bashku me personin e moshës rreth 48 vjeç duke hipur në automjetin Volsvagen furgon AA660 OC, ku në drejtim të automjetit hipin person i moshës 48 vjeç, të cilët lëvizin në drejtim të Fushë-Krujës, rruga e Kombit, Kukës.*
*Oral3:05, Automjeti Volsvagen furgon AA660 OC qëndron pranë lokal ''Lugina e Drinit" që ndodhet pranë Urës së lumit Drin, në unazën e qytetit Kukës.Pasi zbresin nga automjeti, shtetasi Admir Hoxha së bashku me personin e moshës 48 vjeç hyjnë në ambientel e lokalit.*
*Or a 13:35. Konstatohet automjeti tip Audi me ngjyrë gri me porlobagazh, me targa AA643 UP, duke u parkuar te lokali ''Lugina e Drinit". Nga automjeti zbresin dy persona (për shkak të largësisë nuk qe e mundur fiksimi i këtyre dy personave), të cilët uen në tavolinën e shtetasit Admir Hoxha dhe personit lë moshës rreth 48 vjeç.*
*Ora 14:15, Konstatohen personal elartpërmendur duke dalë nga ambientet e lokalit, të cilët pasi hipin nëpër automjete, shtetasi Admir Hoxha së bashku me personin rreth 48 vjeç në automjetin Volsvagen furgon AA 660 OC dhe dy personal hipin në automjetin tip Audi AA 643 UP, lëvizin njëri pas tjetrit në drejtim të fshatit Tektan.*
*Ora 17:00, Konstatohen automjetet Volsvagen furgon AA 660 OC dhe Audi Aa 643 UP duke daë nga fshati Trektan, të cilët lëvizin në drejtim të qytetit të Kukësit- Tiranë.*
*Or a 17:20, Automjetet Volsvagen furgon AA660 OC dhe Audi AA 643 UP, qëndrojnë tek karburant 'Boçi", i cili ndodhet në zonën e Fanit, ku personal e lartpërmendur hyjnë në ambientet e lokalit të karburantit.*
*Ora 17:50, Shtetasi Admir Hoxha dhe personi i moshës 48 vjeç dhe dy personal dalin nga ambientet e lokalit dhe hipin nëpër automjete dhe lëvizin në drejtim të Milotit.*

[shqiptarja.com]

Ora 18:30, Pranë rrethrrotullimit lë Milotit, automjeti tip Audi AA 643 UP, ku ndodheshin dy personat, kthehen në drejtim të Lezhës, ndërsa automjeti tip Volsvagen furgon A A 660 OC, ku ndodheshin personi i moshës rreth 48 vjeç së bashku me shtetasin Admir Hoxha, lëvizin në drejtim të të Fushë-Krujë-Rinas.
Oral 9:20, Automjeti tip Volsvagen furgon me targa AA 660 OC qëndron te kompleksi ‘’Ador Resort ” që ndodhet në Rinas.
Ora 20:10, Konstatohet automjeti tip Audi AA485SN duke dale nga kompleksi ‘A dor", të cilin edrejtonte shtetasi Admir Hoxha dhe njëkohësisht pas tij del dhe automjeti tip forislradë Hyndai me ngjyrë të zezë, me targa AA 336 US, të dyja automjetet lëvizin në drejtim të Tiranës, aulomjetit tip Hyndai Aa 336 US kthen në drejtim të fshatit Kashar, ndërsa automjeti tip Audi AA 485 Snvazhdon lëvizjen në drejtim të Tiranës.
Ora 20:25, Automjeti tip Audi AA485 SN parkohe pranë banesës dhe shtetasi Admir Hoxha hyn në amhientet e saj.
**Nga vëzhgimi i lëvizjeve të të pandehurit Admir Hoxha, sipas raportit të vëzhgimit të datës 17.10.2018, kanë rezultuar këto të dhëna si më poshtë:**
Or a 09:10, Konstatohet shtetasi Admir Hoxha duke dalë nga banes a me automjetin tip Audi ngjyrë e zezë, me targa AA485SN, i cili lëviz në drejtim të autostradës Tiranë-Durrës, pastaj kthen në drejtim të Rinasit.
Ora 09:40, Automjeti tip Audi AA 485 SN parkohet në ambientet e e kompleksit ‘ Ador Resort ” që ndodhet në Rinas.
Ora 09:49, Konstatohet automjeti tip Volsvagen furgon ngjyrë gri me targa AA 660 OC duke dalë nga kompleksi ‘Ador Resort”, në automjel ndodheshin shtetasi Admir Hoxha dhe personi i moshës 48 vjeç, të cilël lëvizin në drejtim të Vorës.
Ora 10:02, Automjetit tip Volsvagen furgon AA 660 OC qëndron te Kompania „Bibaj grup Bell Plast ”, që ndodhet në Vorë, ku shtetasi Admir Hoxha dhe personi i moshës rreth 48 vjeç janë konstatuar duke ngarkuar plastmasnë automjetin tip Volsvagen furgon me targa AA 660 OC.
Oral 0:19, Konstatohet automjeti lip Volsvagen furgon AA 60 OC duke dalë nga kompania ‘ ’Bibaj Grup-Bell Plast”, i cili lëviz në drejtim të qendrës tregtare ‘’QTU”.
Ora20:35, Automjeti tip Volsvagen furgon AA660OC ka qëndruar në qendrën tregtare ' ’QTU”, ku shtetasi Admir Hoxha dhe personi i moshës rreth 48 vjeç, janë takuar me dy persona në ambientet e lokalit të ‘’QTU”. Njëperson i moshës rreth 50 vjeç i gjalë, rreth 1.75 m, me flokë lë thinjura të shkurtra, trup i shëndoshë, i veshur me triko të zezë e pantallona xhinse dhe një person i moshës rreth 47 vjeç, i gjatë rreth 1.8 m, trup normal, me flokë ngjyrë gështenjë.
Ora 11:10, Personal e lartpërmendur dalin nga ambientet e lokalit dhe pasi ndahen , personal e moshës rreth 50 vjeç dhe 47 vjeç hipin në automjetin tip Foristradë Hyndai ngjyrë e zezë me targa AA 442 Rl, në drejtim të automjetit hipën personi i moshës rreth 50 vjeç. Ndërsa shtetasi Admir Hoxha dhe personi rreth 48 vjeç lëvizin në drejtim lë të supermarketit “Spar’’ ku kanë blerë artikuj të ndryshëm, kiyesisht lëngje.
Ora 11:25, Shtetasi Admir Hoxha dhe personi i moshës rreth 48 vjeç dalin nga supermarket “Spar" dhe lëvizin në drejtim'të poarkimit, ku hipin në automjetin tip Volsvagen furgon AA660OC dhe lëvizin në drejtim të Rinasit.
Ora 11:43, Automjeti tip Volsvagen furgon Aa660 OC qëndron te hotel "Olivea ” që ndodhet pranë Vorës, ku shtetasi Admir Hoxha së bashku me personin e moshës rreth 48 vjeç hyjnë në ambientet e tij.
